

EMILIOS SOLOMOU
URREJTJA, GJYSMA E HAKMARRJES
ROMAN

BOTIMET TOENA

EMILIOS SOLOMOU

URREJTJA,
GJYSMA E HAKMARRJES

roman

Përktheu nga origjinali greqisht
Kristo Pulla

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2018

Autori: Αιμίλιος Σολωμού (Emilios Solomou)
Titulli në origjinal: Το μίσος είναι η μισή εκδίκηση
Botuar në greqisht nga: Psychogios Publications S.A.

Për botimin e këtij libri në shqip ndihmoi
Ministria e Arsimit dhe e Kulturës e Republikës së Qipros.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Albina Pulla
Korrektore letrare *dhe* përkujdesja grafike: Arlinda Rrushi
Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-02-2

© 2015 by Psychogios Publications S.A.

© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi
me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim
të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Harit

*Në kapitujt që u referohen ngjarjeve reale,
datat dhe toponimet janë ndryshuar për arsye të kuptueshme.*

Dy kokat ishin mbështetur te mobilia, në krah të televizorit *Samsung LCD*. Ishin anuar majtas dhe me një shprehje të qetë në fytyrë. Lëkura iu kishte marrë ngjyrë blu. Buzët, tendosur, në një tentativë buzëqeshjeje, dhe sytë mbyllur. Flokët ngritur përpjetë, të shpupuritur. Andej i kapi dora e vrasësit, i ngriti lart sikur kishte fituar një trofe dhe i vendosi në një vend të dukshëm. Gjaku i mpiksur, i zi, rridhte ngadalë prej qafës. Ishin piklat e fundit të mbetura në damarët që po kullonin. Formonin njolla të vogla, në të dyja anët e tavolinës së drunjtë. Tapeti bojëqielli përthithte çdo gjë që pikonte poshtë. Njolla, në ngjyrë të errët, ishte përtharë. Njëra prej kokave kishte në ballë një plagë prej arme zjarri.

Trupat pa kokë të atyre burrave dergjeshin në dysheme. Ishin qëlluar në gjoks, në një distancë shumë të afërt. Një plumb për njërin, tre plumba për tjetrin. Kishin vdekur tashmë kur po u pritej koka. Gjaku nga qafa e çarë dhe e masakruar kishte formuar një pellg te parketi i drunjtë, ishte futur nëpër të çarat e parketit dhe kishte arritur deri në rrëzë të murit. Këmishët dhe pantallonat u ishin bërë të kuqe nga lumi i gjakut që vërshoi në momentin kur tehu i thikës copëtonte dhunshëm, nga një dorë e pastërvitur, mishin, muskujt, nervat dhe kockat. Thika, me goditje të forta, copëtoi, së pari, atlasin dhe aksin e shtyllës kurrizore, dy vertebrat e para cervikale në pjesën e sipërme të qafës që lidhin kafkën me shtyllën kurrizore dhe me nervat medularë. Pastaj kaloi në pjesën e përparme të qafës, duke shkëputur me goditje të njëpasnjëshme,

jomjeshtërore, gjëndrën tiroide, laringun, karotiden e majtë dhe të djathtë, nervin transversal shpinor, venat jugulare interne dhe eksterne, nervin oksipital.

Kufomat ndodheshin disa metra larg njëra-tjetrës. Njëra e kthyer në drejtim të Akropolit, tjetra në drejtim të Pendelit. Në boshllëkun midis tyre kishte rënë një mbajtëse çelësash hoteli. Në cep ishte flakur një telefon celular *iPhone 5* dhe në kolltukun në krah ndodhej e braktisur një dosje e zezë *Moleskine Pofio Professional*, plot e përplot me dokumente. Stërpika gjaku kishin ngjyer murin e bardhë, tablotë, divanin, tavolinën, dy çantat *Samsonite* prej lëkure dhe të gjitha letrat që ndodheshin mbi tavolinë. Në krah, gotat e vendosura afër shishes bosh *Perrier*, përmbanin dikur ujë natyral me shije limoni. Ndërsa tani, një lëng në ngjyrë afërsisht si rozë, ujë i përzier me pikla gjaku, dallohej nëpërmjet faqeve të tyre prej qelqi. Salloni luksoz i suitës në katin e njëmbëdhjetë të hotelit ngjante me një thertore. Duhma e vdekjes qëndronte pezull mbi kufomat, duke gumëzhitur si miza mbi mishin e kalbur, duhma e frikës. Ndërsa heshtja që mbretëronte, ishte e vazhdueshme dhe e thellë.

Mbi tavolinë kishte mbetur një tabaka me fruta - banane, kivi, dardha - një shishe me verë të kuqe dhe ëmbëlsirë *pastel*. Ndrëçimi i dobët nga abazhurët nëpër cepa, i jepte kësaj skene një dimension jashtëtokësor. Në televizorin që ishte lënë ndezur, ekranin e të cilit e përshkonin vija të çrregullta të përthara në ngjyrë të kuqe, korrespondenti i kanalit *NET* të SHBA-së, po jepte informacionet e fundit nga sulmi terrorist në maratonën e Bostonit. Emisioni i lajmeve vazhdoi me të ftuarit në studio. Sekuenca nga ngjarja në Manoladha, serrat e kultivimit të luleshtrydheve, gjaku në rrugë, dhe dikush që filloi të fliste. Por nuk dëgjohej zëri. Dikush kishte shtypur butonin e zërit.

Perdet lëkundeshin nën ritmin e erës së pasdites që futej nga dera rrëshqitëse e ballkonit, e cila ishte lënë paksa e hapur. Në anën tjetër, përballë dhe disi larg, dallohej Akropoli. Nga rrugët *Mihallakopullu* dhe *Vasileos Konstandinu* dëgjohej mbytur zhurma e automjeteve. Në dyshtemenë e tualetit ishte hedhur një peshqir i bardhë, i lyer në të kuq. Mbi lavaman, para pasqyrës, në një gotë ku ishte stampuar logoja e hotelit, ndodhej furça e dhëmbëve dhe pranë saj pasta e dhëmbëve *Colgate Max White*, veglat e rrojës, kolonja klasike *Shulton Old Spice*, në një shishe të bardhë të 1940-s. E ruajtur me merak.

Në drejtim të dhomës së gjumit vazhdonte një vijë e trashë gjaku. Edhe një trup tjetër ishte braktisur dhe dergjej mbi tapet. Pothuajse i flakur, i kthyer përmbys. Sytë e tij, të hapur tejtejt, vështronin vdekjen. U qëllua në ballë, aty ku gjaku u mpiks dhe mbylli vrimën hyrëse të plumbit. Gjurmët e gjakosura të këmbëve, që dalloheshin në parket dhe në moket, të çonin në dhomën e gjumit. Ishin ndalur para pasqyrës së madhe. Në sipërfaqen e qelqtë ishte ngjitur një fije letre format A4. Mesazhi i shkruar në kompjuter kishte këtë përmbajtje:

*Rregulli i parë:
Ashtu dua u!*

*Në vend! Ku tmerr të madh mbillte
ndër shpirtrat e udhëtarëve.*

21 prill 2013

P.s.: hajdutët mbaruan me malet, zbritën në qytete.

Jorgaqi e bëri këtë!

2/D1

Sot në Athinë, më dt. 23 të muajit prill 1870, i thirrur përpara nesh i poshtëshënuari, merret në pyetje si vijon:

Pyetje: - Si quhesh etj.?

Përgjigje: - Perikli Lori, nga fshati Vilë i Megaridhës, dikur me profesion bujk, i krishterë ortodoks.

Pyetje: - Që kur merr pjesë në veprimtari banditeske?

Përgjigje: - Që në vitin 1856. Pas luftës në Thesali, u bëra pjesë e bandës së Kallabalikit. Atje u njoha me Tako Arvanitakin. Dhe pastaj, pas vrasjes së Kallabalikit, u shoqërova me të.

Pyetje: - Cili është qëllimi i ushtrimit të aktivitetit banditesk?

Përgjigje: - Për t'u pasuruar.

Pyetje: - Ku qëndronit përpara se të vinit në Atikë?

Përgjigje: - Në Livadhja.

Pyetje: - Dhe çfarë bënit aty?

Përgjigje: - Qëndronim nëpër limere, kërkuam dhe na sollën barut, opinga, llokume, dyzet okë miell, mish, verë, djathë të njomë dhe gjëra të tjera.

Pyetje: - Kush ua solli?

Përgjigje: - Nuk e di se kush, këto gjëra i dinte Tako.

Pyetje: - Dhe përse ikët nga ai vend?

Përgjigje: - U tradhtuam, u sulmuam dhe u përndoqëm prej njësive të ndjekjes.

Pyetje: - Pas Livadhjasë, ku shkua?

Përgjigje: - Kaluam në Thiva dhe pastaj na sulmuan në Riconia

dhe në Himadhja. Aty na strehuan dhe na fshehën çobanët, që njiheshin me Takon. Pastaj shkuam në Megaridha. Aty pamë njësitë e ndjekjes dhe u larguam drejt Pendelit, zumë limer në Stamata. Më vonë kaluam në Marathonë, qëndruam për pesë ditë në një përrua dhe, madje, një herë njësia ndjekëse na kaloi aty afër, por nuk na vuri re. Aty në Marathonë u informuam të nesërmen për lordët.

Pyetje: - Pas arrestimit të lordëve shkuat me Hristo Arvanitakin në Kifisia? Ç'mund të na thuash?

Përgjigje: - Hristo donte të shkante aty për të takuar ledin. Kishte marrë letër prej saj, së bashku me një unazë. I dërgoi edhe ai një thikë me dorezë me gurë të çmuar dhe një tespihe po me gurë të çmuar. I shkroi se dëshironte shumë që ta takonte, të bisedonin. Ia premtoi atij, Vainerit. I foli Takos, por ai nuk donte të dëgjonte. “U çmende, ore”, i tha. “Do të ketë xhandarë të fshehur gjithandej. Do të ngjiten pas teje si shushunjat. Do të të kapin”. Hristo i tha se i kishte premtuar djalit se do të takonte të ëmën, se nuk do ta arrestonin, i tha, se ne kishim lordët dhe ata kishin frikë se mos gjërat dilnin jashtë kontrollit. Takoja kundërshtoi, u xhindos, dhe filloi t'i bërtiste. “I gjithë vendi është i rrethuar, do të të hedhin hekurat, nuk do të mundem t'i vras, do të marrin dhe kokën tënde, do të ushtrojnë presion mbi mua që t'i lë të lirë”.

Hristo ishte kokëmushkë. Dhe Takoja, pas shumë përpjekjesh, u bind ta lejonte të bënte sipas kokës së vet, vetëm e porositi të kishte kujdes, të lëvizte në fshehtësi të madhe, aty ku e shikonte se vendi ishte i rrezikshëm. Takoja u çoi fjalë spiunëve të vet, çobanëve, që ta ndihmonin Hriston nëse paraqitej nevoja. Më mori dhe mua me vete, si çirak. Dhe pas nesh vinte Hormova, duke na ndjekur nga larg. Takoja nuk donte ta linte vetëm. Kështu që u armatosëm mirë e mirë për siguri, dhe u nisëm.

Mbërritëm para se të vinte ledi dhe u fshehëm pak më larg urës, brenda në një korie të dendur, pas një shkëmbi të madh. Pak më larg ishte një çoban, ardhur me porosi të Takos, i cili e kishte mësuar se çfarë do të bënte.

Prej së largu pamë një re pluhuri dhe pastaj dalluam karrocën. Qëndroi tek ura dhe po priste. Prej saj zbriti ledi së bashku me një burrë veshur allafërënga dhe po vështronte përreth. Kishte veshur një fustan të gjatë të zi, të cilin e mbante me duar që të mos prekte tokën. Në karrocë pamë edhe një siluetë tjetër, por që nuk dallohej qartë. Duke menduar se rrotull mund të ishin fshehur xhandarë, nuk dolëm nga vendi ku ishim fshehur. Në atë çast u afrua çobani. E pyeti - burri i veshur allafërënga - nëse kishte parë këtë rrotull Hristo Arvanitakin. Dhe ai iu përgjigj: "Arvanitaki nuk vjen asnjëherë kur e presin. Do të të gjejë ai nëse dëshiron". Burri i veshur allafërënga ia tha zonjës në gjuhën e saj. Në atë çast u hap përsëri dera e karrocës dhe andej doli një zonjë në moshë të re. Sigurisht që ngjante me djaloshin, me Vainerin dhe me ledin. Duhej të ishte e bija. Kur vështrova Arvanitakin, dallova se ai e kishte humbur toruan. Ishte verbuar. Vështronte gjatë gjithë kohës vetëm atë. Zonjën në moshë të re, jo atë të moshuarën.

Në atë moment u futën të gjithë në karrocë dhe u larguan në drejtim të fshatit. Siç morëm vesh më vonë, në kafene, kur arritën te rrapi, ledi pyeti fshatarët për Arvanitakët. Kishte një qese të vogël plot me të holla. Nxori disa dhe i qerasi me një faqore raki. Por nuk mori asnjë informacion. Tako kishte aty njerëz të besuar. I kishte porositur kërcënueshëm që më përpara që ta mbanin gojën kyçur.

Qëndruam rreth dy orë në atë korie të dendur. Takoja na priste, i rehatuar në shtëpinë e kryetarit. Gjatë gjithë rrugës së kthimit, Hristo nuk e hapi gojën. Ishte bërë tjetër njeri kur u

kthyem në Oropo. Që atëherë dëshironte ta shihte përsëri ledin e re. Madje edhe në momentin që po i hiqte kokën djaloshit, atë kishte në mendje. E njihja vështrimin e tij, e kisha parë edhe në të kaluarën në Gardhiki.

Në darkë i pikasa tek pinin alkool dhe bisedonin me Takon, ashtu siç e kishin zakon, pasi të tjerët kishin ikur, disa për të fjetur, e disa për të bërë rojë. Unë isha i shqetësuar dhe nuk flija. I tha ta harronte. E kërcënoi shumë. Sytë i shkëlqenin. Takoja donte që t'i jepte fjalën, por ai nuk bindej, nuk donte që të premtonte. “Tani që gjetën lëmë për të shirë, do ta hedhin çështjen në erë”, tha Tako. Pastaj u ngritën të egërsuar dhe u ndanë. “Kemi për t'i paguar shtrenjtë këto dasi, bëj atë që të thashë”, i tha Takoja. “Nuk jam prona jote”, ngriti zërin Hristo. Në mëngjes ia thashë në sy që nuk veproji mirë. Më hodhi një vështrim të egër dhe u largua prej meje. [...]

3/D2

Sot erdhën lajme nga Athina. Nëna e djaloshit më dërgoi një unazë me diamante dhe më shkruante: “Mbaje, por më kthe djalin tim”. I dërgova edhe unë një dhuratë dhe iu përgjigja: “Zonjë, rri e qetë, djali juaj është mirë dhe të dërgon edhe ai një letër. Bëj edhe ti çfarë të mundesh që të mbarojmë një orë e më parë. Të falënderoj për dhuratën dhe do të vij të të takoj”.

*Përshëndetjet e mia,
Hristos Arvanitakis*

4/A2

Por urrejtja është, pa dyshim, jo vetëm një kusht i domosdoshëm, por edhe kusht thelbësor i luftës.

Kornilios Kastoriadhis

Ja pra, përse e bëra.

Nuk është se u zgjova një mëngjes dhe kështu papritur ndjeva urrejtje për ta. Ishte një urrejtje që mbushte gradualisht shpirtin tim, e helmonte pikë pas pike atë, për vite me radhë, që kur isha fëmijë. Që atëherë kur... Gjithmonë do të jehojë në veshët e mi ajo krismë e mallkuar, dhe shpesh do të zgjohem i trembur nga gjumi. *Bam!* Isha fëmijë, dreqin, një fëmijë që nuk i kishte mbushur as dhjetë vjeç. *Bam!* Çast i mallkuar. Po, urrejtja ime shtohet dita-ditës, sa herë që i shihja në televizor, sa herë që dëgjoja lajmet. Të veshur me kostumet e tyre elegante, me çantat e tyre të shtrenjta dhe me butonat prej ari të manshetave. Më vinte për të vjellë. Imazhi i tyre i urryer më kishte mbetur në mendje, më ishte kthyer në një ide fikse që bëhej përherë e më këmbëngulëse pas çdo momenti që kalonte, çfarëdo që të bëja unë.

Fëmijët e uritur, njerëzit që kryejnë vetëvrasje, të pastrehët që shtohen në progresion gjeometrik. Një milion e gjysmë të papunë, 2 800 000 grekë që vuajnë nën nivelin e varfërisë, ata qindra e mijëra që braktisën Greqinë, kryesisht të rinj, duke kërkuar diku gjetkë fatin e tyre. Për të gjithë këta që përmenda, më vjen ndot dhe i urrej.

I urrej sepse shkatërruan edhe vitet e mia të lumtura, sepse edhe sot e kësaj dite, u vendosin një gur varri ëndrrave të mia.

I urrej për gjithçka që përfaqësojnë, për të gjithë ata që përfaqësojnë. Bankierë, njerëz që bëjnë evazion fiskal, financierë, politikanë të korruptuar, bosët e mëdhenj të Fondit Monetar Ndërkombëtar, të Bankës Europiane, të Trojkës. Banditë dhe kryebanditë. Nga një fole grerëzash, nga e njëjta fole grerëzash, sulen që të gjithë. Dhe vdekja merr atë që gjen para.

Këtu ndihet frymëmarrja e dy njerëzimeve, e dy realiteteve. Jetojnë njëri pranë tjetrit, e di mirë këtë. Është vegjëlja dhe plutokracia.

Lexoj për vetëvrasjet, mbaj shënime, mbledh copëza gazetash. Në një dosje vetëvrasjet, në një tjetër krimet dhe vrasjet.

Përpiqem t'i kuptoj ata njerëz që, të dëshpëruar, vendosin t'i japin fund jetës së tyre. Përpiqem ta vendos veten në vend të tyre, të futem në mendjet e tyre, i imagjinoj, ndjek mendimet e tyre. Kaq shumë mjerim, kaq shumë dëshpërim, gjak edhe vdekje. Lexoj për krimet dhe vrasjet. Dëshiroj të mësoj për fatkeqësinë, dëshiroj të zhytem edhe unë në mjerimin e tyre. Dëshiroj të urrej sa më shumë, deri aty ku nuk mban më, ato fundërrina që e sollën vendin deri në këtë pikë. *Politikë do të thotë një organizim sistematik i urrejtjes*. Dëshiroj të urrej sa nuk kam urreyer kurrë në jetën time.

Po, i urrej, i urrej. I urrej një mijë herë. Urrejtja, gjysma e hakmarrjes. Gjysma tjetër...

5/B1

Gjatë gjithë javës, Romanos Serjidhis punon me mish të me shpirt në universitet, me studentët e tij. Ndërsa në fundjavë qetësohet. Sheh filma policorë, mundësisht filma të vjetër bardhezi. Filma amerikanë. Dhe lexon libra klasike policorë, kryesisht Zhorzh Simenon - *Burreci nga Arhangjelsku*, *Njeriu që shihte trenat tek kalonin*, *Fejesa e zotit Ir*, *Ikja e zotit Mond*, këta ishin librat e tij të dashur.

Në mëngjes fle deri vonë. Pastaj fillon maratona e librave, filmave dhe muzikës, duke përjashtuar pushime të shkurtra për të përmbushur disa detyrime dhe nevoja modeste. Si dhe gjysmë ore pasdite, që ia kushton gjimnastikës. Biçikletë dhe pistë vrapimi, me pamje nga Imitoja dhe pylli i Kesarianisë, nën tingujt e muzikës klasike. Barok: Bah, Vivaldi, Skarlati. Të dielave në drekë shkon në shtëpinë ku jetojnë prindërit e tij të moshuar. Një ritual që e filloi pas studimeve të tij në Skoci dhe pastaj iu bë rregull i pandryshueshëm. Shtëpia e tyre është një apartament në një pallat shumë të vjetër, në një distancë prej dhjetë minutash me taksi nga lagjia *Zografu*.

Shkon gjithmonë me një ëmbëlsirë dhe shishen e domosdoshme të verës. Si dhe me gazetën nën sjetull. Gjithmonë rreth orës dymbëdhjetë. Lexon gazetën për ndonjë orë, i heshtur në kolltuk, duke i kthyer vazhdimisht faqet e saj. E ëma e ndjek me sy teksa përshkon vazhdimisht sallonin, duke zvarritur këmbët dhe pantoflat e saj. Shtrembërime fytyre, psherëtima, përthyerje të letrës. I ati qëndron përballë, i heshtur dhe duke tymosur, duke numëruar faqet e gazetës që i biri i kalon me të shpejtë.

Pastaj e ëma jep sinjalin: “Gati!”. Zënë nga një qoshe në tavolinën e rëndë prej druri, ndërtuar nga i ati shumë vite më parë. Është momenti kur shkëmbejnë të rejat e ditës. E ëma flet për Andonin, të vëllain e tij në Angli, “që nuk do të vijë as sivjet në verë me gruan e tij, pasi do të shkojnë në Francë”, për sëmundjet, për shtrenjtësinë. I ati flet për kolegë të tij që punonin në të shkuarën në ndërtim, për Tripolitit që e takoi rastësisht në rrugë, për birrën që pinë së bashku në lokal, për pallatet që janë ndërtuar pak më poshtë aty në lagje, “ndërtime mjerane, me materiale të lira, që një ditë do të shemben me tërmetin e parë që do të bjerë”. Ndërsa ai u flet për udhëtimin që do të ndërmarrë javës pasardhëse në Itali për një kongres, me temë *Fenomeni i grabitjeve në Greqi dhe në Itali gjatë shekullit të 19-të - ngjashmëri dhe ndryshime*, dhe gjatë gjithë atyre ditëve të mos e kërkojmë më kot, nuk do të jetë në Greqi.

Pastaj rrinë përsëri të dy bashkë, babë e bir, në kolltukët pranë vetratës së ballkonit. Në gramafonin e vjetër dëgjohet Kazanxidhi, *Jetë e pashpirt... Nga vitet e vegjëlisë...* Tymosin dhe pinë ngadalë verën që ka mbetur, e cila është gjithmonë e kuqe. Verë cerigote. Një varietet të cilin banorët e Kithiras në Izmir e rimbollën në ishull nga Kukluxaja, para shkatërrimit të Izmirit. Në kuzhinë dëgjohet rrjedhja e ujit në lavapatë, zhurma e tenxhereve, e pjatave që mbështeten njëra mbi tjetrën në kulluesen e pjatave. Dhe ai vështron nga kati i pestë pallatet e reja, gjigante, të ngurtësuara në mjegull, ato pallate që do të shemben me tërmetin e parë, vështron ballkonet e mëdha, perdet e mbyllura, çatitë me tjegullat e kuqe të shtëpive modeste të refugjatëve. Vë re një tufë gargujsh që çajnë qiellin me nxitim, që ngajjnë si pika të errëta, që bien si shigjetë mbi pemët e parkut, për t’u mbrojtur. Pastaj shiun që bie pjerrtas e ngjan me kordele të holla, piklat e shiut që kërcejnë mbi parvaz

duke lëshuar një tingull të kadifenjtë. Poshtë nëpër rrugë buçasin rrëketë e ujit, teksa zbresin nga kodrat përreth dhe nga ullukët e ndërtesave, lëpijnë buzët e trotuareve dhe humbasin nëpër kthesa dhe në kanalizimet e nëndheshme.

Gjyshi i tij vendos në këtë vend në moshën dymbëdhjetëvjeçare, i përndjekur me zjarr edhe hekur nga Kukluxaja e Azisë së Vogël, së bashku me të ëmën dhe motrën e tij, në varfëri të skajshme. Gjyshi e humbi të atin në batalionet e punës - Amele taburu¹. Nuk e panë më të atin e tyre. Në një shtëpi të tillë, të varfër e të vogël, jetoi dhe vdiq gjyshi i tij, Romanosi i parë. Aty lindi dhe i ati i tij. “Mallkuar qofshin shkaktarët, politikanët batakçinj. Ata i bënë të gjitha. U shërbenin interesave të të mëdhenjve. U interesuan ndonjëherë për popullin e thjeshtë? Hëm... E flakën në zjarr dhe e lanë aty të digjej e të piqej”, thoshte vazhdimisht ai. I vinin ndër mend fjalët djallëzore të princit Andrea që i tha Metaksasë në dhjetor të vitit 1921: *Do t'ia vلente me të vërtetë që t'ia dorëzonim Izmirin Qemalit, që t'i bënte copa-copa të gjithë ata njerëz të pavlerë*. Po, e përsëriti shpesh këtë frazë, të thënë nga njerëz të mençur, fjalë për fjalë, e mësoi përmendesh dhe tund kokën i pikëlluar.

Të atit i shkoi jeta në ndërtim. Kishte punë të rëndë, të thjeshtë, por të ndershme, që të paktën i siguronte vazhdimisht pagën ditore. Gjithmonë. Me ato që fitonte, i shkolloi dy fëmijët, atë dhe të vëllain e tij. “Të jesh i ndershëm dhe i sinqertë. I ndershëm

¹ Që funksiononin në Azinë e Vogël gjatë Luftës së Parë Botërore dhe shkatërrimit të Izmirit. Kryenin punë të detyruar dhe në këto batalione dërgoheshin burra të moshës 15-48 vjeç, kryesisht grekë dhe armenë, që punonin në kushte tmerrësisht të vështira. Ishin një prej metodave të spastrimit etnik që adoptuan xhonturqit e Qemal Atatürkut. Në këto batalione të punës humbën jetën qindra mijëra grekë.

dhe i sinqertë, të kesh besë”, i thoshte gjithmonë. “Të mos i bësh padrejtësi askujt gjatë gjithë jetës tënde.” Kjo ishte trashëgimia e tij. Nuk bëri pará të madhe, dhe as prona të patundshme. Nuk kishte shumë shkollë, por për shkatërrimin e Izmirit kishte lexuar libra të ndryshëm. Dëshironte të mësonte për jetën që kishin bërë aty i ati dhe gjyshi, për rrushin e famshëm razaki, për varietetin erp-kara - arikara dhe për verën e Kukluxasë. Të mësonte për rrënjët e veta dhe për parajsën e humbur. Të kishte një përgjigje. Përse ndodhi gjithë ajo e keqe e madhe, përse ndodhi ajo tragjedi? Kush janë përgjegjësit? Kush fshihet pas historisë zyrtare? Me atë gjykimin e tij të thjeshtë, krijoi një pikëpamje. Dhe, në njëfarë mënyre, në një mënyrë të çuditshme, ajo dëshirë e zjarrtë e atij njeriu të thjeshtë për historinë, kaloi te Romano Serjidhi. U bë historian që të hulumtonte të shkuarën, të bënte pyetje mbi bazën e përgjigjeve dhe të jepte përgjigje në bazë të pyetjeve. T’i jepte thellësi kohore dhe perspektivë jetës së tij të përkohshme.

Pak muaj pas daljes në pension të të atit, Serjidhi mori ftesë për të marrë pjesë në një kongres që organizohej në Izmir. Donte të merrte me vete dhe prindërit. U bëri dhuratë biletat e avionit dhe hotelin. E ëma nuk donte, ndërsa i ati shkoi. Gjetën fshatin, që sot quhet Altinjak, pyetën për shtëpinë e Serjidhëve, gjysmë anglisht e gjysmë turqisht, por edhe me gjuhën e shenjave, por askush nuk dinte t’u thoshte gjë. I ati kishte dëgjuar shumë histori nga gjyshi Romano dhe kishte lexuar po aq të tjera, por në Kulkuxa nuk gjeti gjë. As kishat, as ambientet e distilimit, as punishtet e vajit të ullirit, as hapësirat e pamata me vreshtat e famshme. Vetëm shkolla me mure prej guri, e vitit 1921, në qendër, kishte mbetur. Shkuan gjithandej, u futën në një kishë të rrënuar, panë disa shtëpi të vjetra, me mure të çara, prej guri, prej tullash, me dritare prej druri që ishin kalbur, që ndoshta kishin qenë shtëpi

grekësh, u ulën në qendër të fshatit për të pirë kafe. Kjo ishte e gjitha. U kthyen të heshtur në Izmir me taksì. Gjatë dy ditëve pasardhëse, i ati i tij ishte pa qejf. Nuk doli fare nga hoteli. U mbyll brenda. As në breg nuk donte të dilte, aty ku humbën kaq jetë njerëzish. Jo, nuk donte. Nuk e duronte dot. “Të poshtrit... të poshtrit...”, thoshte me vete. Romanos Serjidhis e dinte se kujt i referohej. *Mallkuar qofshin...*

Kështu i kalojnë zakonisht të dielat, të ulur nëpër kolltukë duke tymosur, duke pirë verë, me alternime heshtjesh të zgjatura dhe komentesh mbi aktualitetin - për Trojkën, për masat e reja shtrënguese, për pensionin e zvogëluar, për taksat. Pastaj i afrohet dhe e ëma. Zhytet në divan. Me ato syze me skelet të trashë dhe me pajisjet e qepjes. Gishtëzën, penjtë, gjilpërat, kuvaristrat... Të arnojë ndonjë çorape, ndonjë këmishë, të forcojë tegelin e ndonjë fustani të vjetër që ishte harruar për vite në dollap, të qepë ndonjë pecetë apo mbulesë tavoline. Serjidhi vështron gishtërinjtë e saj të gjatë dhe të shtrembër që mundohen me zhdërvjelltësi, me gjithë moshën e saj, që t’i japin formë rrëmujës, t’i vendosin penjtë në radhë. Qëndron edhe ajo e heshtur për njëfarë kohe, dëgjojnë që të tre orën që troket te mobilja e saj e drunjtë te cepi, thua se po i vë në gjumë. I ati kotet, mbyll sytë, dhe anon kokën.

Serjidhi e njej këtë heshtje të së ëmës. E di se sa përpjekje bën brenda vetes që të nisë bisedën. Të gjejë fjalët. T’i vendosë në radhë. Gjithmonë i njëjti avaz. E ka merak. Dëshiron ta shohë dhëndër. Të krijojë familje, të ketë gruan dhe fëmijët e tij. Dhe nipër për të. *Nëse mbante shpresa tek ai tjetri, i uruari, dhe bashkëshortja e tij angleze... ajo... ajo... Kaq peshq në det, atë gjeti të peshkojë?*

I ati hap sytë. “Hajde, tani, po e tepron, mbylle këtë muhabet, vajzë shumë e mirë është. Përderisa e pëlqen djali, ty nuk ka ç’ të duhet”, e qorton ai. Por ajo të njëjtin avaz. *Ajo... dhe ajo...*

“Vitet kalojnë, more bir, duhet të marrësh një vendim. Shiko, se mos gjesh ndonjë vajzë të mirë nga vendet tona”, e sjell bisedën aty ku i dhemb.

I ishte bërë fiks. Në fillim Serjidhi nxehej. E ndërpriste bisedën si me thikë, i thoshte se nuk pranonte sugjerime për jetën e tij personale. Jeta ishte e tij, do të bënte çfarë të donte me të. I ati mbante anën e tij. “Lëre... Mirë të thotë djali. Përse fut hundët ti?”

I vjen keq për të. E di që vuan dhe i vjen keq. Vështron sytë e saj të lotuar dhe pendohet që i flet rreptë. Kështu, pak e nga pak, e lejon të thotë atë që dëshiron. Dhe ajo gjithmonë gjen një mënyrë të tërthortë, ta sjellë bisedën tek po e njëjta temë. “Jorgo, këtu në kat të gjashtë, i biri i zonjës Llukie, u bë përsëri me djalë. Gruaja e tij lindi të mërkurën. Besoj se djalin do ta pagëzojnë me emrin Llukë”, thotë ndërsa vazhdon të qepë.

Serjidhis e dëgjon dhe nënqesh lehtë, madje fillon edhe të argëtohet. Me humor dhe cinizëm. “Dje në mëngjes nuk kisha mësim dhe vajta në meshë. Në meshën e Shën Andreas. Tani do të kemi shumë festa, njëra pas tjetrës. Nesër pasdite është mbrëmësojja. Them të shkoj. Aty afër, tek lagjja ime”, thotë duke mobilizuar gjithë seriozitetin e tij.

E ëma i hedh një vështrim të shpejtë. Akoma nuk e ka kuptuar se ku do të dalë. “Ti në kishë? Ha-ha-ha! Si të erdhi? Je gjë i sëmure? Ti jashtë kishës të kaloje dhe të dukej e tepërt...”

Por ai vazhdon: “Dhe, për Pashkë, them të shkoj për disa ditë në Agion Oros. Do t’i hedh një sy dhe arkivave të tyre për librin që po shkruaj”. Një bandit kishte gjetur dikur strehë aty dhe vdiq murg në pleqëri të thellë, aty i harruar. Autoritetet ligjzbatuese e kërkonin gjithandej, por ai nuk gjendej. E vërteta u zbulua disa vjet pas vdekjes së tij.

Ndërsa ajo këmbëngul. “Duhet të marrësh një vendim, bir”, thotë, dhe merret me gjilpërat dhe penjtë duke qepur... pajën për nusen që priste.

Ai hesht, ndërsa ajo i hedh një vështrim fshehurazi. Në atë çast lëshon bombën.

“Nënë, të të them diçka... Kam kohë që e mendoj. Them të shkoj të mbyllem në manastir. Ta braktis universitetin.” Hakmarrje.

Zgurdullon sytë, mbetet gojëhapur. Derisa serioziteti në fytyrën e tij bie dhe Romanos ia plas të qeshurit. Ndërsa asaj i kthehet zemra në vend. Ngre duart, bën kryqin, një herë, dy, tri. E do nënën e vet, e ka pikë të dobët. Po, e shikon që po torturohet. Por çfarë të bëjë? Kështu vendos njeriu, kaq e lehtë qenka?

Sigurisht që gjatë gjithë atyre viteve kishte pasur marrëdhënie me gra. Marrëdhënie rastësore. Por edhe serioze, që kishin zgjatur më shumë, por ato u fundosën në rutinën e përditshmërisë, zjarri u shua brenda kompleksitetit të ndjenjave, të fjalëve, të hezitimeve, të dyshimeve.

Ndërkohë, gjatë muajve të fundit, diçka po ndryshon. Dhe për herë të parë ka ndjesinë se po qëndron përpara një dileme torturoese. Nëse më në fund do të duhet të kalojë kufirin e jetës prej beqari dhe të dalë në bregun përballë. Së fundmi po del me një grua të re. Marrëdhënia me të mbush jetën e tij. Dhe kur bëhen bashkë, ndihet i plotësuar, mund të thuash se është i lumtur. Kështu dëshiron të besojë se ndihet edhe ajo. Por, a është e lehtë që të lërë mbrapa tij realitetin, ashtu siç e njeh dhe e përjeton për kaq vite? Jo, nuk e di.

6/G1

Apostollu është ulur në krye të tavolinës. Përballë e shoqja, Ana, ndërsa majtas dhe djathtas djemtë e tyre. Një moment i rrallë, sepse zakonisht ai mungon. Sapo erdhi nga zyra. Është e diel. I thirrën të gjithë urgjentisht në Drejtori. Lejet u anuluan. Nuk arriti as të ndërrohet, mban ende veshur uniformën e shërbimit me shenjat e saj dalluese, yllin e artë dhe flakëmbajtësen. Pas vrasjes së anëtarëve të Trojkës, pak para mesditës, policia është në gjendje alarmi. Këqyrje të vendit të ngjarjes, kontroll në hotel, mbledhje njëra pas tjetrës deri pasdite vonë. Derisa të ndahen kompetencat dhe përgjegjësitë, u err. Dhe kur gjërat morën drejtimin e duhur, kur uji u fut në rrjedhë, dhe secili mori përsipër pjesën që i takonte, ata... pa portofol, u larguan në pritje të një urdhri të dytë.

Apostollu buzëqesh. Bën përpjekje për të buzëqeshur. Djemtë e pyesin për vrasjen e katërfishtë. Ndoqën lajmet në televizor, gjithë ditën dëgjonin sirenat, makinat e policisë dhe autoambulancat që zhurmonin për orë të tëra në qendër dhe në lagjet përreth. U bë nami. Ai nuk përgjigjet, kurrë nuk përgjigjet, asnjëherë nuk diskuton në shtëpi për çështjet e punës - kur ndodhet në shtëpi, gjatë orëve që zakonisht njerëzit mblidhen në shtëpi. Kjo është detyra e tij.

“Unë di aq sa dini dhe ju”, u thotë. Gjithmonë po ajo përgjigje, gjithnjë e njëjta gënjeshtër. Të vegjlit nuk janë syleshë, tundin kokën, përdredhin buzët të pakënaqur. Është një gënjeshtër pa zarar, dhe që ndërkohë e nxjerr nga pozita e vështirë në të cilën ndodhet. Dhe pastaj ai ndryshon temën e bisedës. Gjithmonë këtë gjë bën, ndryshon temë, dhe kur do t'i rrëshqasë përgjigjes, e

rrotullon vidën në kahun e kundërt. Kthehet përsëri te Andros, te Amollohos. Nostalgjia. I është bërë fiksion. E do ishullin, e do fshatin e tij. Dhe përpiket që këtë dashuri t'ua transmetojë edhe fëmijëve. Muajin tjetër, që janë Pashkët, do të kalojnë një javë në shtëpinë e gjyshit dhe të gjyshes.

“Përsëri në Kullën e Janulit do të na çosh, përsëri te çezma e Gjonatit, te Dyzet Shenjtorët. Prapë do të vrapojmë nëpër vende të shkreta për të bërë fotografi”, ankohet më i vogli prej djemve. Apostollu buzëqesh përsëri. U premtonte se këtë herë do t'i çojë në vende që nuk kanë qenë më parë, në shpellën e Aladhinos, në kullën e Bistit dhe tek ujëvarat, tek ujëvarat e mrekullueshme. Përpiket t'i marrë me të mirë. Do t'i lejojë të mbajnë *Leica*-n, të bëjnë dhe ata fotografi. Mund të shkonin në Zorko, të vendosnin aparatit në trekëmbësh, të shohin dhe me lenten pesëqindëshe të aparatit, të fotografojnë zogj, pulëbardha, skifterë, fajkonj deti, kuptohet, nëse do të kenë fat. “Nuk doni? Madje jo vetëm kaq... por mendoni... se kemi dhe specialitetin e gjyshes, *furtalen*.”

“Vetëm atë... asgjë tjetër”, thotë i madhi, nxënës në vit të dytë të shkollës së mesme.

“Jo, nuk është vetëm kjo. Janë dhe fishekzjarrët si edhe *maskullat* - lodrat që shpërthejnë me tym e zhurmë gjatë festave. Luftë e vërtetë bëhet për Pashkë...”

“Mos u bëni grindaveçë”, u heq vërejtje e ëma. “Kemi tre vjet që nuk kemi shkuar të gjithë së bashku në Andros. Për ju po e bëjmë. Sado që nga ana ekonomike... Ne jse, gjyshërit tuaj kanë çdo të drejtë që t'ju shohin herë pas here. Nuk mund t'i privojmë nga kjo e drejtë. Tashmë janë të moshuar...”

Ulin kokën mbi pjatë qejfprishur, i futen gjellës. Pulë me patate në furrë. Diçka pëshpëritin, diçka hungërijnë dhe pastaj

heshtin. Piruni që troket në pjatë duket se mbahet nga një dorë e pastërvitur. Dëgjohet uji që rrjedh nga kana nëpër gota.

“Kalova nga agjencia, mora biletat”, thotë Ana. “Që javën e kaluar i kanë rritur çmimet. Gjashtëdhjetë euro më shumë në total. Shfrytëzim i pastër”, flet e indinjuar.

Apostollu tund kokën. Përtyp ushqimin, e kapërdin, dhe fshin buzët me pecetë. E kupton.

“Përfundimisht, duhet të gjendet një mënyrë për t’u dhënë fund këtyre spekulimeve”, thotë. Pastaj pyet djemtë për shkollën - ka rast tani që i ka para syve - si shkojnë me mësim, nëse i madhi vazhdon të grindet me mësuesin e historisë.

“Nuk e duroj dot më, - i thotë ai, - nuk e di sesi do të mbarojë ky vit shkollor. Për çdo gjë Bizanti e ka fajin. Nëse do të mundej, edhe për krizën e sotme Bizantin do të bënte përgjegjës”, ankohet, dhe në vazhdim fillon ta imitojë, duke ndryshuar zërin dhe duke lëvizur duart në mënyrë të çuditshme: *Shfrytëzonte njerëzit e thjeshtë, popujt, shtetet fqinje, ishte brutal, fetar deri në neveri.* Pastaj, i indinjuar, vazhdon me zërin e vet: “Dhe, më e keqja... ajo nuk ishte perandori greke, ishte një mozaik shumëkombësh, i dënuar të zhdukej herët a vonë”.

Tani Apostollu qesh i përmbajtur. Nuk e merr seriozisht. I biri është tip luftarak, nuk i ngjan aspak. Ai ka një jetë të tërë që ul kokën. Në shkollë, në universitet, dhe tani në punë. Gjithandej. I vjen mirë për të birin, që është dinamik, kërkues. I pëlqen. Është dhe ky një avantazh në xhunglën që jetojmë.

“Merreni me mend, dje na tha se bizantinët gërvishtnin ikonat që t’u hiqnin bojën ose thërrmonin kockat e shenjtorëve dhe i hanin gjatë kungimit të shenjtë. Do të jetë ndonjë anëtar i Partisë Komuniste, ose akoma më keq, ndonjë anëtar i SIRIZA-s. Budallallëqe të tilla dalin e thonë vazhdimisht tani së fundmi, për Azinë e Vogël, për

greqishten e vjetër, e të tjera si këto. Nuk durova më dhe i thashë që nuk e di nëse kjo që thotë është e vërtetë, por besoj se nëse ka ndodhur, do të ketë ndodhur vetëm disa herë, në raste të veçanta. Nuk mund të përgjithësohet. Nuk ishte i tillë Bizanti.”

Apostollu vazhdon të buzëqeshë. Ana i hedh një vështrim të rreptë dhe ndërhyr.

“Po, Hristo, vazhdo ti, madje mund t’i thuash edhe se mirë bën që reagon. Krenohu me të! Në fund, te Agimi i Artë do të përfundojë. Këto çështje politike nuk kanë vend nëpër shkolla. E kuptove, Jani?” thotë duke u kthyer nga i biri. Pastaj qorton më të voglin, i cili e la ushqimin dhe u hutua duke dëgjuar diskutimin: “Ti, Apostol, mendjen te pjata!”

Apostollu i jep të drejtë. Nuk po vepron siç duhet. I kthehet edhe ai të birit.

“Ty, nga një vesh të hyjnë, nga tjetri të dalin. E kuptove? Nuk është nevoja të fillosh përplasjet me të. Në fund të fundit, është mësuesi yt. Çfarëdo që të thotë, duhet ta respektosh. Kur...”

Dhe në atë çast... në atë çast bie celulari. Ana ngre kokën dhe e vështron përsëri e dëshpëruar. Ajo e di, ka një parandjenjë. E vështron edhe ai. E kupton. Shikon numrin në ekran. Lëshon pirunin në pjatë, pecetën në tavolinë. Ngrihet dhe shkon në dhomën e tyre të gjumit. Dhe kur kthehet, pas dy minutash, lëshon i dëshpëruar një *më vjen keq*, dhe vështron fytyrën e ngrysur të së shoqes. I duhet të largohet urgjentisht. E kërkojnë në Drejtorinë e Sigurisë. E kërkon vetë drejtori. E lë ushqimin në mes dhe ikën.

Vetëm një herë kishte qenë përsëri në zyrën e drejtorit. Së bashku me policë të tjerë, të sapograduar. Një njohje e shkurtër, shtrëngim duarsh, këshilla. Ishte midis shumë të tjerëve. Por tani, tani e ka përballë. Atë dhe zëvendësin e tij. Ndihet i vogël, shumë i vogël para shiritave të artë, yjeve të argjendtë, shpatës dhe flakëmbajtëses

në formë trëndafili, që shkëlqen në spaletat e tyre. Ata gjeneralë leitnantë, ai polic major.

Është e vërtetë, ka një ndjesi të çuditshme. Është po ai nervozizëm që ndien dikush ditën e parë të shkollës. E çuditshme, por aty i shkoi mendja. Humbi në thellësinë e viteve. E mban mend ende atë nervozizëm spontan. Dhe nuk ka për ta harruar deri në fund të jetës. I ngjitej të përpjetës me hap të shpejtë, me çantën hedhur në sup. Gulçonte. Kishte frikë. Nuk donte të vonohej. Shikonte shpesh nga gardhi mësuesin në oborr me shufrën e drurit në dorë. E dinte. I kishin treguar fëmijët e tjerë, kishte parë pëllëmbët e gjakosura të duarve të tyre. Jo, nuk donte të vonohej.

“Na mëson shkrim e këndim duke na rrahur”, i kishin thënë. Dhe e përfytyronte pamjen. Librin në njërën dorë, shkopin në dorën tjetër. Kështu do të mësonte shkrim e këndim.

Dhe ja ku gjendet tani. Përpara drejtorit. Si një nxënës shkolle që pret. Ankth. Zemra i rreh fort. Djersitet. Drejtori është pak më shumë se gjashtëdhjetë vjeç, i mbajtur mirë, me flokë të thinjur, paksa tullac. Me një zë të rëndë, si të ndryshkur. E vështron për një moment drejt e në sy. Sikur dallon aty habinë, hezitimin e tij. Në dorë mban një stilolaps Parker të florinjte, që e kërcet me nerva mbi tavolinë.

“E, pra, polici major Apostollu, bashkëpunëtorët e mi më thanë fjalët më të mira për ju”, fillon ai. Pastaj pauzë.

Mbetet përsëri duke e vështruar paksa çuditshëm dhe duke u menduar si i hutuar. Sikur tani që e kishte të gjallë përpara syve të dyshonte nëse të gjitha ato që dëgjoji ishin apo jo të vërteta, a është vallë kaq i aftë?

“Studiova dosjen tuaj. Dhe... konfirmova gjithçka që lexova aty. Pashë që keni kryer specializim në Shtetet e Bashkuara, për çështje që kanë të bëjnë me hetimin e krimeve ordinere. Por le të flasim pa dorashka. Pak më parë, shefi i Sektorit të Vrasjeve dha dorëheqjen.

E kam këtu”, thotë me një zë të ngjirur dhe ngre lart një copë letre. “Dëshiroj të jem i sinqertë me ju, zoti Apostollu. Në drekë i ngarkova çështjen e vrasjes së katërfishtë në hotel... dhe e paralajmërova. Ose do t’i zbardhte shpejt ato vrasje, ose do t’i fluturonte koka. Kryeministri është i shqetësuar, është shumë i shqetësuar. Gjatë pasdites më thirri urgjentisht në selinë kryeministore. I bëjnë presion. Europeanët dhe amerikanët. Duan të gjenden vrasësit. Kur u ktheva, shefi i Sektorit të Vrasjeve u shtir se kishte një problem. Arsye personale, arsye shëndetësore, diçka të tillë. Nuk ishte i aftë të përballonte peshën e përgjegjësisë. I kërkova menjëherë të jepte dorëheqjen. Për Policinë Greke, ky rast është çështje nderi. Dhe për vendin është çështje sigurie e nivelit të lartë. Zoti Apostollu, po ju flas sinqerisht. Dhe dua që edhe ju të jeni i sinqertë me mua. Ju kërktoj ta merrni ju përsipër këtë çështje. Në rast se përgjigjja juaj do të jetë pozitive, në momentin që do të dilni nga kjo zyrë do të jeni shefi i Sektorit të Krimeve, do të jeni nëndrejtori i ri policor. Do të mbetet pezull vetëm firma e ministrit për gradimin tuaj. Vetëkuptohet se, nëse dështoni, do të rrezikohet koka juaj, por do të rrezikohet dhe koka ime. Së bashku kemi për të shkuar në skëterrë. Polic major Apostollu, a mund ta mbani këtë peshë mbi supe? A mund ta merrni përsipër këtë çështje? Përgjigjen e dua tani, në këtë çast.”

Apostollu kapet në befasi. Propozimi i Drejtorit të Policisë ishte i paparashikueshëm. Në mënyrë të rrufeshme mendon për alternativat që ka. E shqyrton me mendje për pak sekonda. Nuk ka kohë. *Koha juaj fillon që në këtë moment.* I duhet të përgjigjet. Shpejt. Si atëherë... Kur ishte polic i thjeshtë. I kujtohet. U fut së bashku me një kolegun e tij në një apartament në Kipseli. Me armët të drejtura përpara. Kishin informacione për lëndë narkotike. Iu drejtua kuzhinës, ndërsa kolegu, dhomës së gjumit. Atëherë u dëgjua e shtëna. Dëgjoi një *ah! Aaah* të stërzgjatur, të dhimbshme - të kolegut të tij. *Aaaah!* Pastaj dëgjoi zhurmën që bëri trupi teksa

rrëzohej. Ktheu kokën në korridor dhe pa kriminelin me pistoletë në dorë. Sapo kishte qëlluar dhe po matej t'i jepte goditjen fatale policit, i cili, i shtrirë mes një pellgu gjaku dhe me sy të zgurdulluar, vështronte vdekjen drejt e në sy. Apostollu e mori vendimin në mënyrë të rrufeshme, nuk hezitoi, shkeli dy herë këmbëzën dhe tjetri ra përtokë i vdekur. Thirri ambulancën. Kolegu shpëtoi falë tij, ia hodhi paq. Vetëm me një plumb në sup. Një plagë jo shumë e thellë. Ndërsa ai mori gradimin e tij të parë.

E, pra, Apostollu, kjo është sfida e madhe, mendon me vete. Përpara ke greminën, ndërsa mbrapa lumin e rrëmbyeshëm. Çfarë duhet të bëjë? Ishte i mësuar me sfida. Për kaç vite, punën e vinte mbi gjithçka, mbi veten, mbi familjen. Prandaj bëri përpara, prandaj u gradua dhe arriti deri këtu ku ishte sot. Jo pa gjak. Kjo arritje kishte dhe kosto. Por tani kishte shansin e madh të ngjitet në hierarkinë më të lartë. Kaq herët. Por ai nuk vuan nga ambicia infantile. Por kishte një jetë që e priste këtë çast. Dhe ja ku erdhi. Erdhi më shpejt. Ky është shansi i tij. Ose do ta rrokë këtë shans, ose do të bjerë në greminë. Dhe me vete do të marrë dhe familjen e tij. Të ardhmen e saj. Risku është i lartë.

Por... por, a mund të mos pranojë? A mund të tradhtojë besimin që ka drejtori tek ai? Të injorojë vullnetin e tij dhe të vazhdojë, thua se nuk ka ndodhur asgjë? A mund t'i thotë jo detyrës së tij? A nuk po lufton për këtë detyrë për vite me radhë, me integritet, pa u tërhequr dhe pa bërë kompromise? Jo, nuk mundet. Nuk mund t'i injorojë të gjitha këto. Përgjigjja është se nuk mundet. Dhe përgjigjja për drejtorin është *po*, një *po* e thatë, që ngjitet e ngjitet e ngjitur, thellë nga gryka e tij. E dëgjon atë *po*-në papritmas, a thua se e kishte thënë një i huaj, dikush tjetër, ky nuk ishte zëri i tij. Jo, nuk është. Por pastaj ngre kokën dhe ia ngul vështrimin drejtorit, një vështrim të drejtpërdrejtë dhe të sigurt.

- Do të bëj çfarë të mundem, drejtor! Çfarë është njerëzisht e mundshme për të justifikuar besimin tuaj.

Im atë vinte në shtëpi i shqetësuar, i hutuar. Kthehej nga puna fytyrëngrysur. Qëndronte për pak me ne në verandë, sa për të qenë “i pranishëm” e për të na thënë një mirëmbërma. Nuk ishte mirë. Ishte si i përhumbur në botën e tij. I flisnim dhe shumë herë mbetej gojëhapur, duke vështruar në boshllëk, duke vështruar dritat e qytetit, apo yjet lart në qiell.

Pastaj ngrihej dhe ikte. Shpina dukej sikur i rëndonte, kishte filluar të kërrusej, duart t’i vareshin, dhe një peshë e padukshme, shumë e rëndë, e gjunjëzonte. Mbyllej në zyrën e tij. Nëna ime shqetësohej, ngaqë nuk e dinte arsyeën. E dalloja në fytyrën e saj të pikëlluar. Në sytë e saj të bukur bojëqielli, që bëheshin të turbullt, që befasi e humbitnin ngjyrën dhe ishin gati të mbyteshin nga lotët. Po, shihja lotët që shfaqeshin në cepat e syve të saj. E dëgjonte netëve, në orë të vona, që rrotullohej në krevat krahas saj e nuk gjente rehat. Të psherëtinte. Dhe pastaj dilte në ballkon, duke ecur në majë të gishtave që të mos e ndiente ajo. E ngulte vështrimin drejt lindjes, mbi Nikozinë e pushtuar dhe Pentadhaktillon, dhe tymoste cigare njëra pas tjetrës. Në mëngjes, nëna e gjente tavllën e duhanit të mbushur me bishta cigaresh. Plot e përplot. Hi duhani dhe bishta cigaresh të shtypura, të përthyera. *Rothmans Royals*. Nuk i tha kurrë se çfarë e gërryente përbrenda. Nuk donte. Donte të vuante i vetëm. Gjoja e kishte nga puna, nga ankthi, ngaqë donte të hapte një dyqan të ri. Nëna ime dyshonte se nuk ishte kjo arsyeja. Im atë nuk kishte qenë kurrë kështu. Tani mes tyre ishte krijuar një hon i thellë. Një hon i errët, i pakalueshëm. Edhe

ai e dinte që nuk bëhej i besueshëm, por lëshonte një justifikim çfarëdo, sa për të rrëshqitur. Të vërtetën e mësuam më vonë. Atë buzëmbremje kur ai kishte ikur, kishte ikur një herë e përgjithmonë nga jeta jonë.

Nuk e pati të lehtë jetën im atë. Jo. Braktisi fshatin e tij, Shën Epiktiton në Kerinia, i përndjekur në ferrin e luftës. Në momentin kur okupatorët po arrinin te shtëpitë e para, në rrëmujën që mbretëronte dhe në momentin që avionët lëshoheshin, gati për të hedhur napalmin, për të vjellë zjarr dhe hekur, ditën që festonte profeti Ilia, ai i mbytur në djersë, nga ankthi dhe frika, vrapoi për të shpëtuar. “Ik, ik, në drejtim të Pentadhaktillos do të të arrijmë”, i thanë prindërit e tij që donin të mblidhnin një bohçe me rroba nga sënduku dhe të merrnin ca të holla nga vendi ku i kishin fshehur. Motra e tij nuk ndodhej aty, ishte në kampin veror në Troodhos. Ajo ishte larg, nuk rrezikohej. Ai mbante në duar koburen shumë të vjetër dhe shpatën e stërgjyshit të tij, të Dhrakos, të mbështjella me një copë çarçafi të vjetër. Ia dha i ati në momentin e fundit. “Ki mendjen!” E përcolli te dera, i rrahu shpatullat, i tha “vrapo!”, dhe u largua. I mbante në duar dhe vraponte, vraponte pas njerëzve që ia mbathnin të tmerruar. Atëherë ishte vetëm dhjetë vjeç. Kaloi para automjeteve të mbështjella nga flakët, afër kufomave të karbonizuara. Erë mishi të djegur, trupa të ngurtësuar. Duar të ngritura përpjetë, të drejtuara nga qielli. Dhimbje dhe tmerr dallohej në ato fytyra të shpërfytyruara. *O Zot!* Tmerr. Ktheu kokën në anën tjetër dhe shpejtoi të largohej, duke iu marrë fryma. Kthente kokën pas dhe vështronte, por njerëzit e tij nuk dukeshin gjëkund, sikur i kishte përpirë dheu. Përshkoi i vetëm Pentadhaktillon, kaloi majën e tij dhe mbërriti në Nikozia. Gjeti strehë në një shkollë fillore ku kishte shumë njerëz, të ngjeshur si sardele. Flinte përtokë, mbante

radhë për të marrë racionin e ushqimit, por pa e lëshuar nga dora atë copë beze ku kishte mbështjellë kujtimet e çmuara të familjes. Bënte kujdes që të mos i humbiste, të mos ia rrëmbente njeri. Nuk donte të pritej kordoni ombilikal me rrënjët e tij, me historinë e tij. Pas dy apo tri ditësh dëgjoi në radio njoftimin e Kryqit të Kuq. Dëgjoi emrin e tij, emrin e fshatit të tij, vendin ku humbi. E kërkonin të afërmit, të cilët, në momentin e fundit, para se të mbyllej plotësisht rrethimi, mundën të shpëtonin. Dhe kështu u bashkuan përsëri. U hodh në krahët e së ëmës dhe me kokën të mbështetur në gjoks dëgjonte tingujt e mbytur të zemrës së saj, që filloi të rrihte përsëri, dhe shihte lotët që i rridhnin në faqe. Kishin menduar se nuk do ta shihnin më, se humbi në zjarrin e luftës. Midis kaq të vdekurve, kaq refugjatëve dhe fatkëqijve aty në kamp, ata ngjanin të lumtur, duke stonuar me atë realitet. Por kurrë gjërat nuk do të ishin njësoj si më parë. Jo, kishte marrë fund jeta pa kokëçarje, kishte marrë fund pafajësia fëmijërore, kishte marrë fund parajsa e tij. Një dorë e padukshme, një drapër, çau ajrin dhe e zgjoi nga ëndrra.

Për muaj të tërë jetuan në çadër, dhe për disa vite nëpër lagje refugjatësh. Në shtëpi me blloqe betoni, me pllaka zdrukthi, me llamarina. Gjyshi im vdiq në një dhomë të ngushtë që ngjante si qeli burgu. Vdiq nga kanceri. Prej marazit. Në momentet e fundit, kur vdekja ngrinte lart draprin, ai kujtonte se ishte përsëri në plantacionin e tij me limona. Buzëmbremje. I dukej sikur mbante përsëri lopatën dhe vadiste limonët. Ndjeu përsëri aromën e dheut të lagur dhe të luleve të limonit. Dhe buzët e tij, të shtrënguara prej dhimbjeve, u qetësuan. Dhe para grahmës së fundit, një buzëqeshje e çiltër u ravijëzua në buzët e tij. Kështu u largua gjyshi im nga kjo botë, duke buzëqeshur. Gjyshja ime e ndoqi në atë rrugë pak vite më pas. Aq vite sa u deshën për të martuar

motrën e babait tim. Çifti, pas një jave do të nisej për në Australi. Si emigrantë. Kishin shtruar dy apo tri tavolina për të ftuarit. Një darkë e varfër martese. Darkë lamtumire. Gjyshja herë pas here largohej mënjanë, ngaqë ngashërehej. Sytë i mbusheshin me lot. Çfarë gëzimi... Shtëpinë e tyre, atë shtëpi të vjetër aristokrate me ballkonin e madh buzëdetit, nuk e panë më kurrë. As plantacionin me limona të gjyshit. As atë nuk e panë më.

Im atë mbeti jetim kur ishte në vitin e fundit të shkollës së mesme. E motra donte ta merrte aty ku jetonte vetë, në Australi. I dërgoi ftesë, i dërgoi dhe biletat. Këmbënguli, por ai nuk donte, nguli këmbë, nuk donte të shkonte në kurbet. Jetoj për disa vite te një hallë e tij dhe ëndrrën që kishte për të studiuar, e braktisi. Sado që e dëshironte një gjë të tillë, vështirësitë ishin të pakapërcyeshme. Donte të bëhej gjeolog, botanist, biolog, diçka e tillë. Blinte libra dhe lexonte. Lexonte për gjeomorfologjinë e Qipros, për insektet endemike dhe bimët. Për faunën. Jo, nuk pati mundësi të studioje. Që në moshën njëzetvjeçare, pasi kreu ushtrinë, iu fut punës me kokë. Si fillim, vetëm për një copë bukë. Derisa, pak nga pak, grumbulloi disa të holla dhe, kryesisht me pará hua, hapi dyqanin e parë. *Pajisje peshkimi, Jorgos Sokardhis*. Ishte i fiksuar pas peshkimit, i ishte bërë si sëmundje. Që kur ishte fëmijë. Peshkonte me vegla të improvizuara, me fill të lidhur pas një kallami, që e siguronte nga përroi aty pranë, dhe me një paramanë të shtrembëruar si grep. Pas mësimit, flakte çantën në shtëpi dhe ikte vrik për peshkim. Futej midis shkëmbinjve, në brigjet dhe në gjinjte e vegjël e të shkretë të fshatit të tij. Shtëpia e tij ishte dy hapa larg detit. Kështu, pasionin e tij e ktheu në profesion. Dyqani i vogël pati sukses, dhe huaja u shlye. E zgjeroi aktivitetin duke hapur një dyqan me sipërfaqe njëqind e pesëdhjetë metër katrorë. Hapi dhe një dyqan tjetër, dhe

shumë shpejt Jorgos Sokardhis, refugjati që nuk kishte asgjë, që mbërriti në zonën e lirë të Qipros vetëm me një palë pantallona, u shndërrua në importuesin ekskluziv të markave të njohura të pajisjeve të peshkimit. Bashkëpunonte me firma europiane, amerikane, japoneze. Furnizonte jo vetëm tregun e Nikozisë, por u shtri edhe në qytete të tjera. Për një periudhë dhjetëvjeçare ndërtoi një perandori të vogël. Me ndihmën e fatit, këmbënguljen dhe merakun për punë.

Më pëlqente të vërtitesha nëpër dyqan, të sodisja fjetet e peshkimit, tapat shumëgjyreshe, peshat për zhytjen e rrjetave, grepat, kallamat e peshkimit, mekanizmat për mbledhjen e fillit. Pajisje peshkimi sipas preferencave dhe sipas takatit. Pasditeve kaloja andej dhe dëgjoja historira nga peshkatarët që vinin aty për të blerë. Të ekzagjeruara apo jo, të vërteta apo pjellë e fantazisë, të gjitha ato që tregoheshin, më kujtonin përrallat e *Një mijë e një netëve*. Babai im e zgjaste edhe më tej bisedën. Nuk mund ta imagjinoje se sa anekdota dinte në lidhje me peshkimin, anekdota të panumërta. Zakonisht shokuese. I tregonte para meje, dhe nëna e qortonte. *Përpara fëmijës?* Ishte një rrëfimtari i mrekullueshëm. Besoj si të gjithë peshkatarët, pak a shumë. Lexonte gjithçka që kishte të bënte me peshkimin, me peshqit dhe sjelljen e tyre, derisa arriti të kishte në shtëpi një bibliotekë të pasur, të rëndësishme dhe të specializuar.

Në këtë mënyrë i ndërtonte marrëdhëniet me klientët e tij. U qëndronte besnik dhe ata ia shpërblenin në të njëjtën mënyrë. Shkëmbejin informacione. Me disa prej tyre shkonte edhe për peshk në fundjavë. Me kallamin e peshkimit dhe me varkën në det të hapur, për të hedhur rrjetat. Nëpërmjet leximit, eksperiencës dhe eksperimenteve, perfeksionoi teknikën e tij. Ishte peshkatar i zoti, shumë i zoti. Peshku nuk mungoi asnjëherë në shtëpinë tonë.

Me merakun që e karakterizonte ndërtoi dhe shtëpinë tonë. Në një kodër, që të shihte Nikozinë si në pëllëmbë të dorës. Ishte si një pallati i vogël. Me faqen ballore modeste, ndërtuar me gur, dhe me një ballkon që të kujtonte shtëpinë e vjetër aristokrate në fshat. Kështu e donte. Këto udhëzime i dha arkitektit. U kushtonte rëndësi hollësive, dhe i kontrollonte ustallarët përditë. Donte që darkave të shihte dritat e qytetit tek shtriheshin poshtë këmbëve të tij, dhe përballë të kishte Pentadhakillon, të mund të ëndërronte. Matanë vargmalit, buzë detit, në rrëzë të malit, aty ndodhej fshati i tij. Mbyllte sytë dhe imagjinonte sikur ndodhej përsëri aty.

Vetë e projektoi kopshtin, vetë gërmonte, mbillte, ujiste, krasiste, spërkaste. Aty rrinim pasditeve dhe darkave gjatë muajve të verës, nën një strehë prej druri që e kishte ndërtuar po vetë. Rreth e rrotull mbolli trëndafila të kuq, rozë dhe të bardhë. Pak më poshtë shtrihej qyteti, dhe përballë ishte Pentadhakillos. Në mbrëmje, i errët, i plagosur nga flamuri i pushtuesit, dhe i shndritshëm nën dritën e diellit.

Pastaj erdhi epoka e artë e bursës. Miku më i mirë i tim eti, që kur ishin nxënës në shkollë të mesme, drejtonte një agjenci burse. E këshilloi që të investonte. Nuk i tha asgjë nënës sime. Nuk e dinte njeri. E mbante të fshehtë. Investoi një shumë të vogël. Kështu filloi. Dhe, siç ndodh zakonisht, shumta e vogël u bë e madhe. Iu hap oreksi, por edhe risku u bë më i madh. Miku i tij e bindi të investonte dhe me shumta të tjera. I premonte, i betohej se pas dy vjetësh, e shumta, kapitali fillestar do të ishte rritur aq shumë, sa që as vetë ai nuk do ta besonte.

“Si vezët e blinit, miku im, havjar i zi”, i tha tjetri duke nënqeshur në gjuhën që e dinte aq mirë. Do të shlyente shtëpinë, do të bëhej pronar i dyqaneve që deri tani i kishte me qira, do të na siguronte për gjithë jetën dhe unë do të kisha mundësi të studioja

në universitetet më të mira jashtë shtetit. Atë që nuk mundi ta arrinte ai vetë, ëndërrën e tij të përealizuar, donte ta jetoja unë.

Treguesit në bursë ngriheshin vazhdimisht. Babai mori hua, merrte hua dhe investonte. Vinte në shtëpi duke përjetuar një eufori të shfrenuar. Brenda dy vjetësh do të fitonte aq sa nuk kishte fituar ndershmërisht, me djersë, për pesëmbëdhjetë vjet. *Blini havjar të zi*. Do të priste deri në fund të vitit 1999, ky ishte kufiri kohor që kishte vendosur, para agimit të mijëvjeçarit të ri, që të merrte në dorë fitimet dhe të shlyente borxhet. Atëherë do të na komunikonte lajmin e madh. Dhe për ta festuar, kishte blerë bileta për një udhëtim të madh në Amerikë. *Surprizë!* Nju-Jork, Florida dhe Majami, Teksas, Arizona dhe Grand Kanion, Kalifornia, Los Anxhelos dhe San-Francisko, Uashington.

Pikërisht atëherë ndodhi katastrofa. Në mënyrë të rrufeshme. Aksionet filluan të rrokulliseshin. Askush nuk blinte. Im atë i humbi të gjitha paratë që kishte investuar. Dhe bashkë me to, humbi edhe ekuilibrin. Gjithçka që kishte ngritur me aq mund, u shkatërrua në çast. E dinte që biznesi i tij tashmë kishte falimentuar. Borxhet kolosale. Shpina e tij përkulej nga dita në ditë, kërrusej e kërrusej. Në fillim qëndronte për pak me ne në kopsht, ngaqë i ishte bërë zakon. Zhytej në heshtje, diçka pëshpëriste me buzët e tij të zbardhura, dhe zëri i humbiste gradualisht. Ajo masë e madhe dhe kompakte pranë meje nuk ishte im atë. Ishte një hije, një boshllëk. Tani nuk shihte më dritat e qytetit poshtë nesh, por humnerën, një boshllëk të paimagjinueshëm, një skëterrë që e përpinte. Pastaj zvarritej te zyra e tij, dhe mbyllej aty për orë të tëra, i vetëm. Netëve ngrihej nga shtrati dhe e gdhinte në ballkon, duke tymosur, derisa lindte dielli.

Marrëveshja prapa krahëve, që kishin bërë bankierët, financierët dhe politikanët, solli katastrofën. Gjysma e familjeve

kishin investuar në bursë dy miliardë euro brenda një viti. Financierët shfrytëzonin rastin, bankierët jepnin kredi, politikanët inkurajonin për investime, pakica dhe dinakët nxirrnin fitime me thasë në kurriz të shumicës, të naivëve dhe të padjallëzuarve. Dy miliardë eurot kaluan në duart e shtresave me të ardhura të larta. Fare lehtë. Askush nuk vajti në burg, askush nuk u dënua.

Dhe një pasdite dëgjuam një *bam!* *Bam*, ai tingull i thatë i mallkuar, shumë i shkurtër, depërtues, çau ajrin dhe arriti te ne. *Bam!*

Në fillim nuk e kuptuam. Menduam se u rrëzua diçka. Diçka e madhe dhe e rëndë. U thye. Nëna ime hyri brenda. Kur hapi derën e zyrës, lëshoi një britmë. Pashë tmerrin në fytyrën e saj. Sytë e zgurdulluar ngjanin me detin në furtunë, muskujt të tendosur, lëkura e zbehtë. Në momentin që ajo po zmbropsej e tmerruar, vështrova mbi supet e saj. E pashë, e pashë tim atë. Ishte i përkulur përpara, mbi tavolinën e punës. Letrat, llullat prej druri të koleksionit të tij, të gjitha ishin bërë gjithë gjak. Në ekranin e kompjuterit, një vijëz e kuqe rrëshqiste akoma për poshtë. Te tëmthi i djathtë dallohej një vrimë. Aty kishte depërtuar plumbi, doli nga tëmthi i majtë dhe u ngul në mur. Në mobilie, në tavolinë, poshtë në dysheme, ishin ngjitur qime flokësh, gjak dhe copëza nga truri.

M'u duk sikur më rrëmbeu një dallgë dhe më flaku thellë në det. Ndoshesha në rrugën *Stadhiu*, duke vështruar botimet e reja në vitrinat e *Janusit*. Letërsi, histori, ese. I dëgjoja. Fillimisht mbyturazi, si një jehonë e nëndheshme, e papërcaktuar. Oshtima e turmës ngjan me oshtimën e detit që vjen nga thellësitë. E shihja të afrohej. Mendova të futem në librari sa të kalonte e keqja. Por më tërhoqi vëmendjen pasioni i atyre njerëzve. I ndiqja si i hipnotizuar. Kështu u gjenda në mes të turmës, pa dashje dhe pa e kuptuar. I shpërqendruar, i dërrmuar në mes të furtunës, pa pasur mundësi që t'i shmangem. Të parët ecnin me hap të ngadalhtë, ata që ishin mbrapa, shtynin. Dëgjoheshin parulla, të bërtitura, dhe ata që ishin në krye, u drejtoheshin të tjerëve nëpërmjet altoparlantëve. Larmi zërash, larmi fjalësh. Muzikë. Këngë revolucionare. Shihja buzë që hapeshin e mbylleshin, damarë që fryheshin, nën atë qiell të vrenjtur, gati për të shpërthyer shiu. I kuq. I kuq. Një lumë njerëzish i kuq. Banderola, flamuj, bluza. Të kuqe. Gjithçka e kuqe. Edhe pankartat me parullat. Për Trojkën, për Bashkimin Europian, për politikanët e shitur. Dalldisje. Të gjitha së bashku formonin një gumëzhimë, një vorbull me pëshpërime, fjalë, zëra, britma. Turma ngjante me një kope që shkante e vinte, që blegërinte, që hungërinte, që lehte. Më dukej sikur po rrëzohesha, sikur po rrokullisesh në një vorbull dhe po rrotullohesha, sikur po më përpinte vrima e zezë. Vorbull thithëse. Marrje mendsh. Po humbisja kontaktin me realitetin. Këto ndjeva, marrje mendsh.

Aty ku turma rrallohej, duke parë majtas e djathtas me bisht të syrit, dallova njerëz me maska. Çantat i kishin të varura në supe. Ngjanin me krijesa të çuditshme, që u shfaqën papritur nga thellësitë e tokës dhe dolën në dritën e diellit. Pastaj u dëgjuan xhama që thyheshin, që bëheshin copë e thërrime e binin poshtë. Mbante erë tym, erë plastikë e djegur. Në dyqane shpërthyen flakët. Rreshtat e protestuesve u prishën. Njerëzit vraponin, ecnin me hap të shpejtë përpara. Të rinj me bluza të kuqe shkulën mbajtëset prej druri dhe tubat plastikë të flamujve dhe të parullave, dhe godisnin njerëzit me maska. Kundër tyre u sulën dhe forcat e ndërhyrjes së shpejtë të policisë. Aleancë, miqësi e përkohshme mes ujqish. Filluan t'i zmbropsin, vendin e tyre po e zinin punonjësit e zjarrfikëseve, që përpiqeshin të shuanin zjarrin me pompa uji dhe shkumë.

Në vazhdim, në *Sintagma*, a thua se u dha urdhër ushtarak *Alt!* - turma ngriu në vend. Përpara tyre pengesat e policisë. Forca speciale të vendosura në rreshta, trupa me pajime të posaçme për përballjen me turmat, me mburoja. Barriera metalike. Pak më tutje, në rrugën *Vasilisis Sofias*, mbi trotuare, furgonat e policisë. Automjete që përdorin pompa uji kundër demonstruesve. Në Pallatin e Vjetër mbretëror, vareshin nëpër dritare nëpunës, ndoshta dhe deputetë, që përgjonin nga lart dhe kalonin kohën duke parë njerëzit që kishin mbushur rrugët *Filelinon*, *Ermu*, *Panepistimiu*, *Vasilisis Sofias*. Nga të gjitha rrugët vërshonin njerëz në drejtim të Parlamentit. Si përrenjtë, që teksa fryhen dhe gjëmojnë tek rrjedhin vrullshëm, sjellin me vete trungje pemësh. Turma po rritej, po dendësohej. Filluan të bien ca pika shiu. Lagështirë. Ftohtë. Nga i ftohti, frymëmarrjet ngjanin me avuj që ngriheshin si shtjella dhe humbitnin në mes të atij shiu të imët që kishte filluar.

Mbërtheva zinxhirin e xhupit tim ushtarak në ngjyrë jeshile dhe mbulovala kokën me kapuç. Vështroja faqen ballore të pallatit mbretëror. Stil neoklasik. Munihi. Histori arti, semestri i dytë. Dhe më erdhi ndër mend huaja - përsëri një hua u fut si pykë në mes - e Ludovikut të Munihut, një *ofertë bujare* për Greqinë nga financat e pasura të Bavarisë, që të ndërtohej pallati mbretëror i mbretit Othon, që i biri i tij të kishte një banesë për së mbari, një kasolle ku të fuste kokën. Kushtoi njëqind mijë lira ari. Shteti i varfër grek nuk e kishte një mundësi të tillë ekonomike, ndërsa për bavarezët nuk ishte asgjë. Në vitin 1843 gjetën rastin, e kërkuan, dhe shteti grek mori përsipër ta shlyente. Dhe, natyrisht, pas dëbimit të mbretit Othon dhe bashkimit të Gjermanisë, Bismarku kërcënoi dhe bëri të mundur që huaja të shlyhej. Jo, po do t'ua linte pa marrë... Por, a nuk ishte njëfarë Raihenbahu, nëntoger i kalorësisë bavareze, më 1833, në kohën e mbretit Othon, që u vendos drejtor në entin e prerjes së monedhave dhe shtypi drahaminë e parë? Po sot, a nuk është një tjetër Raihenbah - Horst quhet tani - prapë gjerman, në krye të Task Forcës, që vendos për çdo gjë në Greqi? Po, të gjitha këto po mendoja dhe humba kontaktin me realitetin. Dhe një pensionist i moshuar që çirrej bri meje, më solli në vete.

Njerëzit ulërinin. Ata që ndodheshin në rreshtat e parë, u konfrontuan me policinë. Disa shanin, të tjerë qëllonin me vezë, me domate, një a dy vetë pështynë në drejtim të rreshtit të parë të trupave speciale të policisë. Pastaj filluan të shtynin. Të tërhiqnin të egërsuar pengesat metalike, në mënyrë që turma të vërshonte drejt Parlamentit. Policët përplasnin shkopinj të te çizmet, mbanin ritmin si vozitësit, si kuajt gjatë galopit, dhe bënë përpara. Filluan të binin shkopinj të parë mbi kokat e njerëzve, filluan tymueset. Dhe në vazhdim bombat artizanale *molotov*. Njerëzit me maska u shfaqën përsëri. Gurë dhe copa mermeri fluturonin në ajër dhe binin mbi policët.

Një bombë me gaz lotsjellës u rrokullis te këmbët e mia. Në mënyrë të rrufeshme u mbështolla prej tymit shumëngjyrësh. E ndjeva të më depërtonte në mushkëri e gati të më mbyste. Sytë filluan të më digjinin. Nuk mund të merrja frymë. Po mbytesha. Po kollitesha. Turma u shpërnda. U ula në gjunjë mbi asfalt dhe mbulova sytë me pëllëmbët e duarve. Me gjithë dhimbjen dhe ankthin për të thithur pak ajër të pastër, për të marrë frymë, ata qëndronin hapur. Më dhembnin. Më digjinin. Lotonin. Kur u përmenda paksa, e kuptova se ndodhesha në qendër të ciklonit. Policë të forcave speciale, nga njëra anë, njerëz me maska, nga ana tjetër, që sulleshin dy e nga dy, tre e nga tre, dhe hidhnin shishe me lëndë djegëse. Pashë një polic të më afrohej kërcënueshëm. Ngriti shkopin e gomës që të më godiste. Por ndërkohë u zbraps, pasi iu sulën ata me maska. “Vrapo, mik, vrapo!”, dëgjova një zë. Vrapova, duke ndjekur pas ato figura të zeza, që po zbrapseshin prapë prej policëve dhe largoheshin drejt rrugicave të afërta. U largova edhe unë bashkë me ta. Kaluam në rrugët *Ermu*, *Athina*, në ca rrugica të ngushta, prapë në rrugët *Athenaidhos*, *Skuze*, në sheshin *Shën Irini*, në rrugët *Eollu*, *Visi*, *Euripidi*, *Menandhru*. Në rrugën *Caldhari*, na doli përballë një furgon policie. “Këtej! Eja me mua, or mik”, më tha një djalosh. Mund të ishte njëzet vjeç, jo më shumë. Hoqi kapuçin e zi dhe mbi bluzën me mëngë të gjata veshi një xhup të bardhë. Flaku në kosh të plehrave çantën dhe kapuçin që e përdorte si maskë. “Përse i hodhe?”, e pyeta. Argjiri. Kështu quhej, siç mora vesh më vonë. Më vështroi për një çast si i çuditur. “Po mirë... nuk...” Atëherë e kuptoi. Nuk isha njeriu i tyre. E kuptoi kur më pa me kokën të zbuluar, pa kapuçin e xhupit tim. E kuptoi që isha gjendur rastësisht në rrugën e tyre. “E marrtë dreqi... Kujtova se ishe... se ishe...”, filloi nga të sharat. Vështroi drejt furgonit të policisë, që ndodhej rreth dyzet metra larg, pastaj

vështroi prapë nga unë. Puliti qepallat. “Spiun je, ore? Ndonjë kalec?”, më pyeti me zë të egër. “Jo, miku im. Nuk jam as spiun dhe as polic. I urrej po aq sa i urren dhe ti. Si ata, ashtu dhe shefat e tyre.” U shtendos, u qetësua. Më vështroi përsëri për pak dhe mendueshëm. “Si e ke emrin?”, më pyeti. Ia thashë. Dhe shtova, nuk e di sesi më erdhi që ia thashë, se jam student në Fakultetin e Filozofisë. “Në rregull, eja me mua”, më tha. Për një arsye, nuk e di sesi, por pati besim tek unë. Ndoshta pa tek unë një shok të ri, përderisa e provova edhe unë dhunën policore. Ndoshta na bashkonte urrejtja jonë e përbashkët. Ndoshta të dy bashkë do të kishim më tepër shanse të çanim bllokun e policëve? Nuk e di...

Nuk doja të ngatërrohesha me anarkistët. Kurrë nuk i kam simpatizuar. Por imazhi i policit që po më ndiqte me shkopin e gomës ngritur lart, furgoni i policisë në rrugën *Caldhari*... Nuk kisha rrugë tjetër, vajta me të. Përshkuam me të shpejtë bulevardin dhe u futëm në rrugën *Plateon*. Pastaj në *Metaksurjio*, *Favieru*, *Akominatu*, në sheshin *Vathis*, në *Majer*, *Aharnon*, *Marni*, *Sturnari*, dhe dolëm në *Eksarhia*. Pra, bëmë një rreth. Kishim rreth një orë që po ecnim, që t’u shmangeshim policive, kontrolleve. M’u prenë gjunjët nga lodhja.

U futëm në një dhomë gjysmë të nëndheshme, si vrimë minjsh, si tunel, në rrugën *Pulheria*, në rrëzë të Kodrës së Strefit. Aty e prisnin dy, tre nga të vetët. Kur u hap dera, ata ishin duke lexuar një tufë me fletushka të zverdhura. I lanë mënjanë. Aty gjithçka ishte në ngjyrë të zezë. Errësirë. Këpucë me qafa, pantallona, bluza, xhupa, të gjitha të zeza. Flokë të gjatë të lidhur me ca llastikë që i gjen me çmime të lira, mbushur me zbokth. “U vonove dhe...”, u matën t’i thoshin Argjirit, por kur më panë mua, mbetën të habitur. Lëvizën nga vendi ku ishin ulur. Argjiri i qetësoi. “Mos kini merak, e kemi mik!” U futën në kuzhinën e vogël. Mbyllën

derën. I dëgjoja të diskutonin. Diçka më kapi veshi, se disa prej tyre u kapën nga policia, madje i çuan në rajon. Pastaj u kthyen dhe u ulën përballë meje. Në pozicion luftimi. Dy në karrige, dy të tjerë në dysheme. Të vrenjtur. Vështrime vjedhurazi, mosbesuese. Heshtje e përkohshme, hezitim. Aty brenda mbante erë këmbë dhe çorape të palara, erë papastërti, erë dheu të lagësht. Muret të zhveshura. Pllakat e dyshemesë gjithë yndyrë. Një tavolinë. Edhe ajo e pisët. Krevatet ndoshta ishin në vend tjetër. Shihja një derë të mbyllur. Aty. Fjetore e përbashkët. Filluan përsëri të lexonin fletushkat. *Dhimitrios Paparigopulos. Pikëpamjet e një banditi.* Teksti i parë anarkist që u shkrua në Greqi. Sot është bërë si manifest që qarkullon në faqet me ideologji anarkiste.

“Çfarë është shoqëria? Një amalgamë shturjeje dhe intrigash, rezultante e smirës dhe urrejtjes, model demonësh. Ligjet u hartuan për të shtypur të varfrit, të pambrojturit, të dobëtit. Rrallë ligjet mbrojnë të dobëtin, por të dobëtit, brenda shoqërisë, janë të fortë...”

Pasazhe si këto, gjepura e pseudofilozofi të tilla, lexonin me zë të lartë. Ndezën një cigare, e kalonin dorë më dorë, rreth e qark dhe me radhë, tymosnin, herë në heshtje me vështrimin e ngulur në boshllëk, duke vështruar murin dhe, herë-herë, duke lëshuar ndonjë fjalë, ndonjë frazë, si të yshturat e plakave, pa lidhje, pa kuptim, fjalë që mbartnin urrejtje, vetëm urrejtje. *Spiunët... kalecët...* Në çdo fjali përmendeshin *kalecët*. Kërcisnin dhëmbët, sytë u lëshonin xixa. Shoqëria, partitë, institucionet, anëtarët e Partisë Komuniste, të Agimit të Artë, shefat e tyre. Budallallëqe. Nuk e dija që ekzistonin njerëz me një urrejtje të tillë të pafundme, me një urrejtje të verbër. Atë ditë e mësova. I takova edhe dy a tri herë të tjera në atë vrimë. Dolëm për të pirë ndonjë birrë në Eksarhia. E ndieja, e dija që po më vinin në

provë. Se po më matnin me kutin e tyre. Shikimet e shtrembra, mënyra se si flisnin, fjalët nëpër dhëmbë, pëshpërimat mes tyre. Nuk isha njeriu i tyre, jo, nuk isha. Ende jo. Por, gradualisht, tekxa pinim, filluan të hapeshin. Lufta guerile në qytete, si t'i vinin kalecët në pozitë të vështirë, liria e luftëtarëve që po kalbeshin burgjeve. Fletushka, gjithkund fletushka. Ngjitje afishesh nëpër mure. Vetëm budallallëqe të tilla thoshin vazhdimisht. Komplete. Përndjekje. Ilegalitet. Policë dhe hajdutë. Parulla me bojë të zezë, thua se ishim në kohën e pushtimit nazist.

I studioja edhe unë. *Kush drekon me satanain, duhet të ketë lugë të gjatë.* Doja të ushqehesha nga urrejtja e tyre, nga ajo mani që kishin, nga tërbimi kundër policëve dhe shefave të tyre. Urrejtje! *Urrejtja pjell urrejtjen, dhuna dhunën.* Dhe një ditë ua thashë në sy. Me gjakftohtësi. “E përse nuk e qërojmë Trojkën? Ata këlyshë me kostume dha kollare që vijnë këtu për të shkatërruar vendin tonë? Lufta me gurë kundër policëve, dy apo tri bomba artizanale, nuk janë të mjaftueshme. Këto gjëra i bëjnë edhe picirrukët e lagjes!”

Më vështruan të habitur. U mbështetën në shpinoret e karrigeve të tyre dhe vështrimet e tyre u kryqëzuan. Ngrinë. Por Argjirin e zuri një e qeshur hysterike. Një e qeshur ngjitëse. Po gajaseshin të gjithë së bashku. Kujtuan se po bëja shaka. Jo, nuk po bëja shaka. Atëherë, ato ditë, në mendjen time po shfaqej mundësia të... Një plan... I takova edhe një herë tjetër. “Përse nuk i qërojmë ata të Trojkës?”, i pyeta përsëri. E kisha me gjithë mend. Dallohej në fytyrën time. Në damarët e mi që fryheshin, që fryheshin të mbushur me urrejtje, në vështrimin tim që shkëlqente nga tërbimi. Nuk bëja shaka. E kuptuan. Po, e kisha me gjithë mend.

Atëherë dëgjova nga goja e tyre përgjigjen më të papritur. Jo, këtë nuk e prisja kurrë. “Trojka na intereson”, më thanë.

Emilios Solomou

Papunësia, varfëria, uria, vetëvrasjet, kriminaliteti, dhimbja, dëshpërimi, reagimet, janë simptomat e para të çorganizimit të një shoqërie. Kishin kaq vite që prisnin një shans të tillë. “Si mendon ti? Pse tani së fundmi radhët tona shtohen gjithnjë e më shumë me bashkëluftëtarë të rinj? Lëvizja anarkiste po forcohet. Po merr përmasa gjigante.”

Kështu më thanë. Dhe nuk shkela më në Kodrën e Strefit. Guerile qytetesh! Marrëzira! Kakërdhi miu! Picirrukë të lagjes. Kjo ishte.

Serjidhis është rrugës për të shkuar në takim. I veshur me shije, si gjithmonë. I vetëkënaqur. Xhaketë *Gucci* ngjyrë bezhë, pantallona *Levi's* me prerje klasike. Këmishë të zezë, këpucë fine prej lëkure. Të gjitha të blera gjatë udhëtimeve të tij për seminare, kongrese, leksione jashtë shtetit.

Taksia e lë në fillim të rrugës *Ermu*. Dëshiron të ecë pak. Kthehet në rrugën *Mitropoleos*. Me hap të gjatë dhe të sigurt. Me ritëm. Në sinkron me frymëmarrjen. Kjo e ndihmon të mendohet. Është në gjendje të mirë shpirtërore, duket nga ecja, nga paraqitja, nga një buzëqeshje që kohët e fundit mezi dallohej në buzët e tij. I vjen të fishkëllejë një melodi. Por pendohet. Vështrimi i tij kalon te njerëzit përreth. Dikush e përshëndet. Ia kthen përshëndetjen duke tundur kokën. Nuk e njeh. Ndoshta ishte ndonjë nga studentët e tij në universitet.

Mendohet, gjithë kohës mendohet. Ecën dhe mendohet. I duhet të marrë një vendim. Po bëhet gati një vit që atëherë kur doli për herë të parë me Katerinën. Ndalon për pak në vitrinën e një dyqani bizhuterish. Vështron. Një prej këtyre ditëve duhet që të vendosë. Kjo i vërtitet gjithë kohën në mendje dhe, megjithëse kaloi një javë, vendim nuk po merr. Psherëtin. Çfarë të bëjë? Vështron unazat, varëset. Përsëri unazat. Prej floriri, prej platini, prej argjendi. I hedh një vështrim orës së tij të dorës. *Guess Chronograph GC*. E ka dhuratë nga Katerina për ditëlindje. I duhet të vazhdojë rrugën, ndryshe do të vonohet. Në cep të rrugës, i del përpara një lypës, i pret rrugën. Rrobat të zgjyrosura, goja pa

dhëmbë, dora e shtrirë për lëmoshë. E kalon. Bën dy hapa dhe... kthehet. Ndoshta papritmas ndjeu brejtje ndërgjegjeje, ndoshta ndikoi gjendja e mirë shpirtërore, ndoshta e shtyn një dashuri e sinqertë dhe e vonët mbarënjerëzore. Kërkon nëpër xhepa. Gjen disa monedha të harruara aty dhe ia vendos në pëllëmbë.

Katerina është njeri i shkëlqyer. Gjëja më e mirë që i ka rastisur gjatë gjithë këtyre viteve. E bukur, e zgjuar, e dashur, e ndjeshme, e matur. Çfarë kërkon më tepër? Ajo e dashuron. E sheh, e kupton. Po, një prej këtyre ditëve, duhet të vendosë.

Qëlloi e pafat në jetë. Ishte shumë e re kur njohu bashkëshortin e saj në universitet. Në Selanik. Dikë... me emrin Taki Karanikolla. Ishte ende një çupëlinë. Dashuria e saj e parë. Ishin studentë që të dy. Ai ishte një aventurier i madh. E ngopi me fjalë boshe, i premtoi jetë përrallore. Fjalëshumë, që vetëm shtirej. Një karagjoz që s'e kishte shokun, kaq i poshtër ishte, por ajo u verbua pas tij, e bindi. Ishte një fundërrinë që rrallë e gjen. E tradhtonte rregullisht, edhe para se të vinin kurorë. Por ajo, nuk kuptonte asgjë. E re në moshë, pa eksperiencë. E ku dinte ajo nga tradhtia dhe pabesia? Duhej të martoheshin, të mbetej shtatzënë, të rritej pak fëmija i tyre, që ta shihte të vërtetën në sy. E zuri me presh në dorë, me një kolege të punës. Me një shumë më të re në moshë, që sapo kishte mbaruar shkollën. Punonte si sekretare. Nuk i kishte mbushur as të njëzetat. I dëgjoi rastësisht në telefon, nga receptori i aparatit që kishin në kuzhinë. Iu errën sytë. Lanë takim në një kafene në *Pangrati*. I tha se do të dilte për kafe me disa kolegë. Ajo i tha se do të shkonte me fëmijën te nëna e saj. E puthi me ëmbëlsi. “Je partnerja ime e përsosur...”, i këndoi me zë të ulët. Ndjeu pështymën e tij në buzët e saj. Mbylli sytë, ktheu kokën në anën tjetër. Iu pështiros. E la fëmijën te gjyshja dhe vazhdoi programin. Gjeti vendndodhjen e kafenesë dhe po priste

pak më tutje brenda në makinë. Pasdite. Ata erdhën me makinën e tij. U futën në kafene. Çfarë torture. Çdo minutë që kalonte ishte një tmerr i vërtetë. E mbërthyer pas timonit, me fytyrën që i kishte marrë ngjyrën e të vdekurve. Dolën përsëri pas një apo një ore e gjysmë. Buzëmbremje, dita po shuhej. U përqaftuan, u puthën gjithë pasion, si të dalldisur. Pothuajse para syve të saj. U përkul. U bëri fotografi me celularin e saj, me duart që i dridheshin. U larguan. I ndoqi. Ndalën diku në Ilisia dhe u ngjitën në një apartament. Lexoi emrat tek citofoni, por nuk arriti të merrte vesh ndonjë të dhënë.

E vuri fëmijën herët për gjumë dhe u ul te krevati i saj. Dhe atëherë qau. Qau për shumë kohë, pa pushuar, lotët i rridhnin çurkë, shpirti i copëtuar. Bota iu shemb. Dëshpërim, dhimbje, inat, tërbim. Pak nga të gjitha. Gjatë gjithë kësaj kohe ajo bënte një jetë të gënjeshtërt. Kur ai u kthye, Katerina ia kishte bërë gati valixhet. Rroba, këpucë, të vendosura rrëmujë, të lara e të palara, veglat e rrojës, furçën e dhëmbëve, laptopin. “E dashur, u ktheva!”, i thirri pa ditur gjë, në mënyrë hipokrite, duke rrotulluar çelësin në derë. Atëherë e pa. E pa tek qëndronte në mes të valixheve të tij, në dhomën e ndenjjes. Me sytë të ënjtur. Në fillim u zbeh, një hije e rëndë i ra në fytyrë. Por pastaj filloi të bënte budallain, të luante teatër. “Nuk është ajo që mendon ti, je keqkuptuar”. Ajo i tregoi fotografinë nga larg. Provat bindëse. I dha ultimatum. “Një orë!”.

Ai ngriti zërin, u mat t’i vinte dorë. “Guxo, po ta mbajt! Guxo!”, e sfidoi ajo. Dhe ai e uli dorën. I mundur. “Një orë!”, i tha prapë. Atëherë i pranoi të gjitha. Gjoja u pendua. Po përdorte kartën e fundit. I tha se ishte një lidhje e përkohshme, rastësore. E para dhe e fundit. I kërkoi ta falte. Ajo ishte jeta e tij, ajo dhe fëmija i tyre. Ajo u fut në dhomën e tyre, mbylli derën me çelës. Hapi celularin. I dëgjoi të gjitha, që nga fillimi. E kishte incizuar. E kishte në dorë. Kishte fakte bindëse.

Por Taki nuk u largua. Fjeti në divan. E dëgjonte se si gërhiste gjatë gjithë natës. Fundërrina! Në mëngjes i kërkoi përsëri që të merrte valixhet e tij dhe të shporrej.

Përndryshe do të shkonte aty ku punonin të dy dhe do t'i turpëronte para të gjithëve. Ai nuk e besoi. “Është e zemëruar, do t'i kalojë”, mendoi me vete. Derisa e pa të nesërmen duke u futur në ambientet e firmës dhe po e kërkonte me sy. Ngriu në vend. E dinte që pronarët e firmës kërkonin pretekste për të pushuar personel nga puna. Vrapoi drejt saj, e kapi nga krahu, e tërhoqi mënjane. “Mos u çmende gjë?” “Mos më prek”, i bërtiti e egërsuar dhe e tërhoqi krahun me forcë. Ai e kuptoi që ajo nuk po bënte shaka. Jo, nuk po bënte shaka. Dhe iu zotua se në mesditë do të merrte gjërat e veta dhe do të largohej. Kështu bëri. Duke besuar ende se ishte një tërheqje e përkohshme, një pauzë e shkurtër. Stuhia do të kalojë, nuk ka se nga t'ia mbajë. Por Katerina pasdite ndërroi bravën e derës. Dhe dy vjet më vonë doli vendimi për divorcin. Me mirëkuptimin e të dyve. Ranë dakord për pensionin ushqimor të fëmijës dhe që ai do ta takonte fëmijën në fundjavë.

Po, ai e tradhtonte vazhdimisht. Atëherë u ndërgjegjësua për gjithçka. Atë buzëmbremje që i kapi në flagrancë, çdo gjë u qartësua. Klikoi në kompjuterin e mendjes së saj. Iu kujtuan justifikimet, ardhjet vonë në shtëpi, punët urgjente që i kishin ngarkuar në zyrë. Justifikime për baterinë e celularit që iu shkarkua, për defektin e makinës, që iu desh ta çonte në servis për riparim.

Katerina ia kishte treguar të gjitha Serjidhit. Nga fillimi deri në fund. Ajo këmbënguli. Nuk dëshironte të ekzistonin hije dyshimi në marrëdhënien e tyre. Duhej t'ia thoshte, i detyrohej për këtë. Po, Katerina ishte një njeri i rrallë. Falënderonte fatin që rrugët e jetëve të tyre u kryqëzuan. Një vit marrëdhënie me atë grua nuk

është pak. Por as shumë. Por tashmë e njihnin mirë njëri-tjetrin. Kishte njohur dhe të birin e saj, Petron. Kishte shkuar disa herë në shtëpinë e tyre për drekë. Kishin dalë dhe disa herë të tre së bashku. Në restorant, në kinema, kishin bërë dhe një ekskursion. Simpatia ishte reciproke. Ishin tifozë të së njëjtës skuadër. Të Panathinaikosit. I premtoi se një të diel do të shkonte ta merrte për të parë ndeshje futbollit. Në Leoforo, tani që do të ndërtojnë dhe stadiumin. Kishte një shall të skuadrës së tyre të preferuar dhe do t'ia sillte. Për një fëmijë, një dhuratë e tillë ia vlen. I vogli shkonte mirë me të. E pse jo? Studionte perspektivën, mundësitë, predispozicionin e tij që të...

Të gjitha këto mendoi gjatë rrugës, derisa arriti në Thisio. E gjeti në restorant duke e pritur. Kishte zënë vend afër dritares që sheh nga rrugica, përballë Portikut të Atalit. Jashtë po errësohej dhe brenda në lokal ndezin dritat, dhe pas pak e ulin ndriçimin. Përkulet dhe e puth në buzë. E përkëdhel te shpatullat. “Sonte je bërë shumë e bukur”, i thotë.

“Edhe ti... je shumë... shumë... *trendy!*”, përgjigjet ajo. Qesh.

Vjen kamerieri për të marrë porosinë. Duan makarona.

“A keni verë *Arikara?*”, pyet Serjidhi.

“Jo”, buzëqesh kamerieri. Nuk e njeh atë lloj vere, për herë të parë e dëgjon.

“S’ka gjë, na sill verën më të mirë që keni”, i thotë.

Dhe kur kamerieri largohet, ajo i kap dorën. Janë të lumtur bashkë.

10/G2

Po agon. Apostollu e ka gdhirë gjithë natën pa gjumë. Ka përpara dosjen e çështjes. Drita e llambës neon në tavan luhartet. Dikush duhet ta ndërrojë. Fërkon sytë. Në dorën e djathtë shtrëngon një filxhan me kafe, nga ato kafetë e shpifura, kafetë e industrializuara, që nxjerr aparati në korridor. Më tepër ujë se kafe. Shtrembëron fytyrën. Vështron nga dritarja, mendueshëm dhe i pikëlluar. Jashtë po zbardh dita. Agu i mëngjesit. Rrezet e para, të virgjëra, të papërlyera, që ngjanin si aureolë lart mbi qytet, vinin me vrull nga botë të tjera për të përmytur Tokën. Do të dëshironte... do të dëshironte që tani të ndodhej diku aty jashtë, nëpër vende të shkreta, me aparatën *Leica* në dorë. Dashnoren e tij! Do të ulej poshtë ndonjë peme a në ndonjë shkëmb. Do të priste lindjen e diellit, nuancat e lehta të së kuqes, të së verdhës, të bojëqiellit, që të përjetësonte rruzullimin në momentin që flakëronte dhe përftonte përsëri formë, *substancë*, ngjyrë. Është rikrijimi i botës, gjeneza. Dhe ai do të ishte aty. Do të donte... shumë gjëra do të donte.

Në zyrën e tij dhe në labirintet e GADA-s - Drejtorisë së Përgjithshme Policore të Attikës - mbizotëronte qetësi absolute. Pyet veten nëse është vetëm. I harruar. Në një botë që befasi u tërhoq dhe u bë inekzistuese. Kaq heshtje, kaq vetmi.

E kishte lexuar dy herë të gjithë materialin e dosjes hetimore. Vështron përsëri fotografitë e kufomave. Dy trupat pa kokë në njëfarë distance njëri nga tjetri, trupi i tretë përmbys. Trupi i katërt te shkallët. Kokat të vendosura te televizori. Në dy anët e tij. Gjithandej gjak. Masakër. Fërkon përsëri sytë.

Pyet veten nëse bëri mirë. A bëri mirë që pranoi propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm? A ishte një propozim? Apo ishte një urdhër? I kishte lënë liri përzgjedhjeje? A e kishte pasur këtë luks? Nuk i kujtohet më. Ajo që kishte ndodhur para pak orësh ishte zhytur, madje, në mjegullën e kujtesës së tij, humbi diku midis surprizës dhe zënies në befasi. Mendon për vështirësitë që e presin. Gjërat nuk janë të thjeshta. Sado që ta nderojë dhe ta miklojë gradimi dhe marrja e drejtimit të Seksionit të Vrasjeve, e kupton se rruga përpara tij është e shtruar me gjemba. Dhe ai është zbathur. Ka rënë në oqean dhe duhet të notojë.

Ndien një si sëmbim t'i ngjitet gradualisht nëpërmjet nervave të kafkës dhe të shtrihet në gjithë kokën. Sytë i mbyllen, qepallat i dridhen, si drita e llambës së neonit në tavan. I hapet goja, gogësin, ndien trupin t'i paralizohet. Duhet të çlodhet, të flejë gjumë. I duhet të shkojë në shtëpi, të flejë një a dy orë, të bëjë një dush, të marrë veten.

Fërkon sytë për të disatën herë. I vijnë ndër mend vitet studentore, fillimisht në Fakultetin Juridik dhe pastaj në Akademinë e Policisë. Si në ëndërr. Betimi, zotimi se do t'i shërbejë ligjit dhe rendit, drejtësisë, qytetarëve. Po, si në ëndërr sheh edhe tani veten e tij në këmbë, me dorën të ngritur, kolegët mbledhur para Drejtorit të Përgjithshëm, para ministrit të Rendit Publik. Hap e mbyll buzët. Është krenar, i emocionuar, i magjepsur nga betimi, detyra, misioni i vështirë. Beson çdo fjalë, e ndien se si i ngjitet në gjoks, fiton jetë, çlirohet me forcë dhe pasion nga goja e tij. Zëri kumbues. *Deri në pikën e fundit të gjakut tim...* Koka përkulet para, i rrëzohet. Pothuajse i përgjumur, pothuajse zgjuar, në një gjendje paralize, letargjie, të qëndruarit pezull, në dritëhije, forma dhe figura të papërcaktuara që shkojnë e vijnë, pëshpëritje, dhe koka e tij e rënduar dhe sytë që puliten të lodhur. Hidhet përperjetë

nga vendi ku është ulur. Shfryn. Duhet ta ketë zënë gjumi. E tashmja është makthi i tij dhe ndodhet përpara tij. Është sfida e madhe. Është sprovë e tij.

Po jeta e tij, ku është jeta e tij, çfarë vendi zë ajo në të gjitha këto? Po familja e tij, Ana? Muajin e kaluar Ana humbi punën. Për njëzet vjet kishte punuar si sekretare në një zyrë të madhe juridike. E prisnin të ndodhte. Nga java në javë, nga dita në ditë. Fëmijët kishin nevoja, shpenzime. Veçanërisht shpenzimet për kurse në lëndë të ndryshme, ishin tashmë shumë të larta. I madhi, në vit të dytë të shkollës së mesme, kishte filluar ndërkohë të përgatitej për provimet e pranimit në universitet. Psherëtiu. Kishte edhe atë kredinë e mallkuar që mori disa muaj para se të shpërthente kriza, pas gradimit të tij të fundit, për të blerë aparatën fotografik. *Leica S2-P*, me të gjitha pajisjet dhe lentet, 37,50 megapixels. Njëzet e pesë mijë euro! Shpenzim i madh, i pajustificuar për të plotësuar tekën e tij. Po pse, e dinte që gjërat do të merrnin këtë rrugë? Psherëtin përsëri. Është një çmenduri. Por është pasioni dhe mania e jetës së tij. Të paktën ky gradim do të rikuperojë, deri në njëfarë mase, gjithë atë mishmash, atë cungim page dhe zvogëlimin e të ardhurave ngaqë Anën e hoqën nga puna.

I duhej ta pranonte. Për shumë arsye duhej të pranonte. Edhe për shkak të detyrës. Të paktën t'ia gjente anën kësaj çështjeje. Të marrë pak frymë. Përndryshe... nuk do as ta mendojë. Jo, nuk do. Përndryshe do të arrijë në fund dhe jeta e tij do të shembet e do të shndërrohet në gërmadha. Ose do të bëjë një hap të rëndësishëm, të ngjitet lart në hierarki dhe fati i tij të ndryshojë rrënjësisht.

11/E1

Dosja “Vetëvrasjet”, fashikulli nr. 26

Opiniononi publik në Kostur është i shokuar nga lajmi se ish-nënkryetari i bashkisë, që mbulonte financat e qytetit, i dha fund jetës së tij.

Kostur, qershor 2013

Nënkryetari i bashkisë kishte dy vjet që përpiquej të vinte rregull në çështjet ekonomike të qytetit. Ishte i ndërgjegjshëm dhe paksa... romantik. Besonte se kishin mundësi dhe se duhej që tashmë gjërat të ndryshonin. Dhe do të mund të ndryshonin me minirevolucione në çdo komunitet lokal, nëse njerëzit që mbanin poste me rëndësi do të kishin si përparësi të ofronin dhe të punonin ndershmërisht për të mirën e komunitetit. Por gabohej.

Ata që lëviznin fijet e padukshme dhe që vinin dorë në arkën e bashkisë, vazhdonin të vepronin në prapaskenë. Shumë shpejt, nëpërmjet kontrolleve të shumta dhe të rrepta që bëri, konstatoi një deficit prej 1,3 milionë eurosh. Dhe denoncoi. Çështja përfundoi në gjykatë. Nënkryetari i bashkisë e kishte ndërgjegjen të qetë. Kishte kryer detyrën. Dhe bashkëqytetarët e vlerësonin për këtë. E takonin në rrugë, i shtrëngonin dorën dhe e inkurajonin: “Kështu vazhdo!”. Kryetari i bashkisë ishte në anën e tij, aleat i tij. I vendosur për të pastruar stallën e Avgjisë.

Por hijet që fshiheshin në errësirë u mobilizuan gjithandej si grabitqarë mishngrënës, filluan të përhapnin lloj-lloj thashethemesh. Dhe nënkryetari përpiquej t'u kundërvihej fjalëve që qarkullonin dhe akuzave. Përpiquej të vërtetonte se nuk është elefant. Pak e nga pak, gërryen nderin dhe emrin e tij të mirë. Propaganda e bëri dëmin. *Nëse gënjeni, duhet që gënjeshttrat tua të jenë të përmasave kolosale. Dhe nga gënjeshttra më e madhe, një pjesë e saj gjithmonë bëhet e besueshme.*

Gruaja dhe fëmijët e tij e mbështesnin. Ndërkaq, gjithçka u kthye kokëposhtë. Shihte bashkëqytetarët e tij, të cilët deri para pak ditëve i shtrëngonin dorën, të ndërronin trotuar, ta vështronin vëngër. Njerëz që besonin lehtësisht dhe me një dozë smire, që ushqeheshin nga problemet e tyre personale, nga pasiguria, nga vështirësitë ekonomike, nga papunësia dhe diskreditimi i përgjithshëm që kishte pësuar sistemi politik, u kthyen kundër tij. Askush nuk i thoshte më “mirëmëngjesi” apo “mirëmbërë”, askush nuk e merrte në telefon për t'i shprehur solidaritet.

Kështu që nënkryetari dha dorëheqjen nga ky post. Në njoftimin e tij, fliste për lodhje psikologjike dhe fizike. Por edhe dorëheqja u përdor kundër tij. Keqdashësit vazhduan ta sulmonin. *Dorëheqja është provë e fajësisë së tij.* Hutat grabitqare filluan të silleshin rreth tij. Nënkryetari ishte tashmë i dobët, i pambrojtur. Nuk mund të luftonte kundër armiqve të tij. I dukej sikur po mbytej, sikur kishte rënë në një moçal dhe zhytej, e zhytej gjithnjë e më thellë. Iu duk se e humbi përgjithmonë nderin dhe emrin e tij. Do ta tregonin gjithmonë me gisht. Një ditë e gjeti të bijën duke qarë. Ajo vrapoi të fshihej, të fshinte lotët. E kuptoi.

Jo, nuk mund të duronte. Sado që ndihej i bekuar nga dashuria dhe mbështetja e familjes së tij, tani gjithçka ishte tej mundësive të veta. Kishte ditë që nuk kishte vënë buzën në gaz. Rrinte në

zyrën e tij dhe mendohej, gjithë kohës mendohej. Nuk dilte. E shoqja i lutej të dilnin një shëtitje, të merrnin pak ajër të pastër. Të ecnin buzë liqenit. Nuk kishte dëshirë, nuk kishte qejf, nuk mundej të përballej me vështrimet plot smirë të njerëzve. U mbyll në vetvete.

Dhe një ditë që mbeti vetëm në shtëpi, improvizoi një lak, dhe e kaloi litarin te trau i çatisë. U ul në karrige dhe mbeti duke e parë, duke e soditur me një vështrim të ftohtë, të zbrazët. Nuk mund të jetonte me ato shpifje. Pas pak do ta kalonte rreth qafës. Pas pak momentesh trupi i tij do të lëkundej në boshllëk. Pas pak... Ky vend nuk do të ndryshojë kurrë... kurrë...

Eci përpara, tërhoqi karrigen dhe hipi në të. U rrëqeth kur laku i ashpër preku lëkurën e tij. Pastaj i dha një të shtyrë karriges. Në atë pozicion e gjetën e shoqja dhe e bija.

Hetimi i policisë dhe autoritetet gjyqësore vërtetuan se nënkryetari i bashkisë nuk kishte asnjë lidhje me shpërdorimin e fondeve prej 1,3 milionë eurosh. Nëpër banka nuk ekzistonte asgjë në emrin e tij, dhe as në llogari të fshehura. Të tjerë e paskëshin pasur dorën të gjatë.

Ai besoj rastësisë? Nuk e di. Rastësisë, ndoshta po, por fatit, jo. Janë veprimet tona ato që përcaktojnë “fatin” tonë. Rastësia dhe ko incidencat janë të pranishme në çdo moment rreth nesh, përgjojnë, shtrijnë këmbën në mënyrë që dikush të pengohet aty. Me rastin më të parë.

Ajo erdhi dhe më foli. Isha ulur në një stol në Parkun Kombëtar dhe po lexoja. Sapo kisha blerë romanin *Vdekja e Artemio Kruzit* në një nga libraritë në qendër të qytetit. Leximi më kishte tërhequr. Humba në faqet e atij libri. Tashmë ishte pranverë. Njëpër një dëgjohej një potpuri cicërimash, krakëllimash dhe rrahje të krahëve të zogjve njëpër degë. Dashnorët e padukshëm!

Dëgjova hapa dhe më pas hija e saj ngjyrë gri u shfaq para meje. U befasoja. Ngrita kokën dhe e vështrova i habitur. Një vegim. I dalë prej një ëndrre. Ishte Galatia, isha Pigmalioni, mbreti legjendar i Qipros. Afërdita e dëgjoi lutjen time. Më buzëqeshi. Të njëjtën gjë bëra dhe unë. Fytyrë e freskët, rrezatuese. Dhëmbë të bardhë, shumë të bardhë, si rruaza, fiks për reklamë. Flokë të zinj të prerë shkurt. Tipare të bukura dhe fine. Fustani prej kadifeje të zezë deri te gjunjët i rrinte ngjitur pas trupit. Po, ishte tërheqëse, shumë tërheqëse. M’u prezantua. Mbante një gazetë të palosur. Njoftime. Mundësi punësimi. Tha se më mbante mend që nga leksionet në sallën në formë amfiteatri të Fakultetit të Filozofisë. Rreshti i fundit i karrigeve, lart. “Po.” Viti i parë. “*Politikë/ politikanë, grabitje dhe terrorizëm. E mban mend?*” Romanos Serjidhis. Ditën që Serjidhi shpërtheu në sallë, pak pasi vdiqën

nëpunësit e MARFIN-it, në demonstratat masive të vitit 2010. “Po, e mbaj mend.” Por pamja e saj nuk më kujtonte asgjë, nuk e mbaja mend. Sa mund të mbash mend nga një sallë e mbushur plot e përplot.

Më kërkoi falje që po ndërpriste argëtimin tim letrar. Dhe nëse po më bezdiste, të... “Jo, jo, aspak”, e sigurova unë, futa në libër treguesin e faqeve dhe e mbylla. “Fuentes?”, pyeti duke vështruar kapakun e librit. “Po”, u përgjigja. “E kam parë së fundmi në një intervistë në televizor. Një program... Si quhet... *Antenat e epokës sime?* Besoj se kështu quhej. Më la mbresa. Kishte personalitet. Njerëzit në rrugë e njihnin, e përshëndesnin, e adhuronin. Më vjen keq që vdiq. Duhej të ishte shkrimtar i madh.” “Po, ishte”, thashë unë, që isha ende i habitur nga ai takim i papritur. Kështu filluam bisedën. Për Fakultetin e Filozofisë, për Serjidhin, për librat, për letërsinë. Ja, pra, dashuria ndërkohë po qëndronte në prapun e shtëpisë sime. Kështu papritur Rubini u fut në jetën time.

I propozova të shkonim te një lokal pak më tutje, te Parku, që ishte dy hapa larg. Do ta qerasja me kafe, apo diçka freskuese. Nëse kishte kohë. Kishte, dhe pranoi. E futa librin në çantë. U ulëm njëri përballë tjetrit. Nuk ishte nga Athina. Vinte nga larg. Nga rrethet, nga Arta. Më tha se kishte mjaft provime të prapambetura. Nuk bëhej ndryshe. Paralelisht i duhej edhe të punonte, në mënyrë që t’ia dilte mbanë. Kishte dhe qiranë e shtëpisë për të paguar. Një apartament të vogël, në lagjen *Pangrati*. Çdo mëngjes hipte në autobus dhe zbriste te Parku, për të qenë afër me qendrën e qytetit. Aty e kalonte kohën, me një gazetë në dorë, duke kërkuar për punë. Kishte disa muaj që kishte mbetur pa punë. Gjatë verës kishte punuar si kameriere në një hotel në Arta. Qeshi. Dhëmbët e saj të bardhë shkëlqyen. Një buzëqeshje joshëse. “Punë e lehtë”, tha. Nëse do të kishte mundësi për të punuar prapë në

ndonjë hotel këtu rrotull, do të ishte... Kishte nevojë të madhe për pará. Prindërit e saj e kishin të pamundur ta ndihmonin, sa të përfundonte studimet. I ati ishte llogaritar në një përfaqësi makinash. Gjatë viteve të fundit, shitjet kishin rënë shumë. Morën tatëpjetën dhe ndërmarrja falimentoi. Dëmshpërblim nuk mori. Çfarë mund të bënte me atë asistencë papunësie që merrte? Të paktën punon e ëma. Në një furrë buke. Paga është e vogël, rrogë sa për të mbajtur frymën gjallë, poshtëruese. Taksat i kanë gjuhëzuar. Por ç'të bësh? Me shumë vështirësi ia dalin mbanë. Me thonj e me dhëmbë. Nejsë.

E lashë të fliste duke e dëgjuar gojëhapur. Buzët e saj, buzëqeshja, ngërdheshja në fytyrë. Vështrimi i saj. Brenda meje lindi ideja më e çmendur. E përse jo? Rubini ishte dhuratë nga Zoti. Ashtu më dukej atëherë. Ishte ajo që kërkoi prej kohësh. Një dhuratë e rastësisë, të cilën nuk e prisja. Kameriere në hotelin e tyre! O Zot! Po, plani im po merrte jetë. Mund të shpresoja. Nëse...

“Çfarë po mendon?”, më pyeti. “Ë?” “Çfarë po mendon? Je hutuar...”, përsëriti ajo. Buzëqesha. Sepse ajo që po mendoja, ajo që befaz u ngul si gozhdë në mendjen time, ishte djallëzore. “Asgjë”, i thashë. “Asgjë.”

E vështroja tek luante me pipëzën. Tek trazonte copat e akullit në gotën me lëng portokalli. E kapa të më vështronte në mënyrë disi të çuditshme. Thua se po studionte fytyrën time, vështrimin, mendimet e mia. “Ah!”, bërtiti befaz. “Diçka më pickoi.” U përkul paksa anash. Unë ndoqa instinktivisht lëvizjen e saj. Ngjithëse, ashtu si gogësitja. Fustani i ishte ngritur mbi gjunjë. Vështrova këmbët e saj. Nuk mund t'i shqisja sytë. Zgjati dorën dhe fërkoj pulpën. “Një mushkonjë”, pëshpëriti. Dhe, në atë çast... Lëkura e saj e bardhë e zbuluar që po shfaqej para meje. E ngjeshur, e lëmuar. Kaq e freskët. Kërciri që dilte i tendosur, sfidues. Fyelltarja nudo

ulur në Fronin e Ludovisit. Po, atë më kujtonte, fyelltaren. Njëra këmbë mbi tjetrën, kyçi i këmbës. Lëkura e lëmuar. Arkeologjia klasike, semestri i parë. Dora. Pëllëmba. Prekja. Skuqja. Faqet flakë të kuqe. Mbylla sytë menjëherë. Por... fantazia ime kishte marrë hov, ishte dalldisur. Mund të ndieja pothuajse përbërjen e lëkurës së saj. Gjakun që rridhte nëpër vena. Nuk e di. Fillova të ndiej brenda meje gjakun e saj të ngrohtë që po ziente. Dhe një dëshirë që po ngjitej rrëmbimthi prej këmbëve dhe kacavirrej shpejt, depërtonte trupin tim, përshkonte të gjitha venat dhe arteriet, të cilat fryheshin dhe rrihnin me të shpejtë.

Kur ajo ngriti kokën dhe më vështroi, mua më erdhi turp, u skuqa. U ndjeva sikur po merrja diçka dhe më kapën në flagrancë. Më buzëqeshi përsëri, e ndrojtur. “Ikim”, më tha. “Më duhet të kontrolloj lajmërimet”, dhe më tregoi gazetën që mbante në duar. Nuk e lashë këtë rast të shkonte dëm. I kërkova numrin e telefonit, i dhashë numrin tim. Ditën tjetër i telefonova, dhe u takuam në të njëjtin vend. Në stolin tonë. Më pëlqente, ishte joshëse. Nuk më shqitej nga mendja. Gjithçka tek ajo ngjante e përkryer. Çfarë tjetër mund të kërkoja? Pyesja veten, torturohesha. Po nëse kishte të dashur? Gjithçka do të shkonte dëm. *Një provë do t’ju bindë.* Dhe çfarë është për t’u bërë, le të bëhet. Tentova ta puth kur ishim te stoli. Mos ndoshta ishte shumë herët? Nuk kundërshtoi. Sikur po e priste. Edhe ajo e dëshironte.

Natën e kalova në apartamentin e saj. Brenda në errësirë trupi i saj i bardhë ndriçonte çuditshëm si xixëllonjat, që pamë me prindërit e mi një natë vere në pyll. Disa femra përpiqen të joshin mashkullin dhe në vazhdim ta hanë. Kur më preku, u rrëqetha, thua se brenda në trupin tim pati ndonjë shkarkesë elektrike. Ishim që të dy të uritur. Të uritur për mish, të pushtuar nga epshi. Bëmë dashuri. E përfunduam me një zallamahi rënkimesh,

psherëtimash, duke dihat. Dy trupa që shfaqen nga dheu, nga guri dhe mermeri, të papërfunduar, si statujat e Mikelanxhelos, që marrin përsëri përmbajtje dhe formë, ngrihen prej letargjisë dhe rrotullohen lart, deri në qiell, drejt përfundimit, drejt përsosmërisë, të çliruar prej natyrës sonë vdekatare, kështu ndiheshim edhe ne. Flinim pak, ajo merrte në prehër një arush të vogël - sa e çuditshme, në këtë moshë? Vinim zilen e orës, mblihdhnim forcat dhe fillonim përsëri, dhe çdo herë me kohëzgjatje dhe kënaqësi më të madhe. Po e mbaj mend atë natë, çdo hollësi të saj, çdo tingull, shikimin, dëgjimin, prekjen, nuhatjen, shijen. Edhe një ndjesi tjetër, e papërcaktuar, e mistershme. A mund ta harroja vallë? Në mëngjes ishim të rraskapitur.

Është e vërtetë. Gjithçka ndodhi kaq shpejt. E kujt i intereson? Donim që të jetonim, t'i përjetonim të gjitha. Sa më intensivisht, a thua se nesër mund të vdisnim. Nuk shkova në fakultet atë ditë. "Që sot do të kërkoj së bashku me ty për punë", i thashë dhe i vulosa buzët me gojën time. Buzëqeshja e saj e shndritshme. Dhëmbët e saj të bardhë. Të marra prej reklamës së ndonjë paste dhëmbësh. Ma kishte dhënë keqas në kokë.

Në këtë mënyrë, çdo mëngjes takoheshim po tek i njëjti stol, në parkun ose në kopshtin e mbretëreshës Amalia, duke mbajtur një termos me kafe dhe dy gota plastike, që të mos na zinte gjumi. Dhe, sigurisht, edhe gazetën me njoftime. "Tani po kërkoj çfarë të jetë, nuk kemi luksin që të zgjedhim", më tha. "Sinqerisht, çfarëdo që të jetë." Mendova të marr iniciativën, fshehtazi, dhe të telefonoj te hoteli, të pyes. Sido që të jetë. Hotel i madh. Me shumë personel. Nuk ka mundësi, do të kenë nevojë për krahë pune. Nëse kërkonin burrë, do të shkoja vetë. Edhe këtë do ta bëja.

Rubini hapi gazetën. Po pija kafënë e ngrohtë dhe e ndiqja tek po lexonte njoftimet. Një për një. T'i shënonte me stilolaps të

kuq. Të kthente faqet. Herë pas here më vështronte. Përsëri ajo buzëqeshje. Një puthje fluturimthi mbushur me pranverë. Qershi në gojën time. Isha i dashuruar vallë? Për dy ditë? Nuk e di. Por ajo që ndiej, ama, prek kufijtë e lumturisë.

Dhe atëherë, ndodhi mrekullia. Njoftimi. Si me porosi. I bërë enkas për ne. Veçanërisht për ne. Në faqen e tretë. I mbyllur në një kuadrat, i dallueshëm, me rreshta të veçantë.

Kërkohet kameriere
me eksperiencë për hotelin

.....

Orar jo i fiksuar.

Pagë e kënaqshme.

Bërtiti. “Kjo është ajo që prisja.” Kapi menjëherë telefonin e saj dhe formoi numrin. Priti për pak në linjë. Pastaj filloi të fliste. E lidhën me një numër të brendshëm. Përgjegjësi i personelit. Një dialog i shkurtër. “Po... po... Kam punuar... në Artë... Dakord. Do të jem aty... në njëmbëdhjetë... Ju faleminderit.” Takimi u caktua në orën njëmbëdhjetë.

13/A6

Tre vjet të tëra po përpiquej nëna ime të gjente një zgjidhje. U përpoq të mbante hapur të paktën dyqanin kryesor. E mbajti për gjashtë muaj, një vit. Nuk mbahej më, gjërat morën rrugën e tyre. Jo, diçka u thye, e nuk ngjitej më. E mori përsipër një administrator, ajo perandori e vogël që kishte ndërtuar im atë duke nisur nga hiçi, falimentoi, u shkërmoq.

Kishim ende borxhe. Kreditorët ushtronin presion, kërkonin paratë e tyre. Kështu që u detyruam të shisnim me çmim qesharak shtëpinë e prindërve të nënës sime në Prokopi. Pastaj shitëm shtëpinë tonë në Nikozia, shtëpinë në Llofo. Kështu e quanim. Ashtu si shtëpinë e vogël në Livadhi. U shkulëm me rrënjë, si refugjatët. Këtë herë, ata që përvetësuan pronat tona, nuk erdhën me anije dhe avionë, nuk drejtuan armët e tyre kundër nesh. Ishin të veshur me kostume dhe kollare. Ishin të civilizuar. Mbanin çanta të mbushura me dosje dhe shkresa me firma, vendime gjykatash. Ditën që largoheshim përgjithnjë nga shtëpia në Llofo, nëna ime ktheu kokën dhe e vështroi për herë të fundit. Rrinte në makinë, në *Volkswagen*-in e vjetër tip *Golf*, mbante timonin dhe nuk i bëhej që të nisej. Qante me zë të ulët. Pastaj shpërtheu në ngashërim. Iu hodha në prehër. Më përqafoi. Pastaj e mori veten disi. Fshiu cepin e syrit me gisht. “Do t’ia dalim”, tha. “Do t’ia dalim... Së bashku”, dhe ktheu çelësin në motorinon e automjetit. U dëgjua një si kollë e ngjirur, lëshoi një zhurmë të thatë dhe të zgjatur, filloi të punonte. U larguam. Nuk kaluam më nga lagjja jonë.

Në këtë mënyrë u paguan dhe borxhet e fundit. Si mëkate. U pagua edhe personeli që humbi punën. Rroga të prapambetura, dëmshpërblime. Një shumë e konsiderueshme u depozitua në Bankën Popullore, që më vonë u quajt Banka Popullore *Marfin*. U zhvendosëm në një apartament me tri dhoma, në kat të dytë, në lagjet e jashtme të Nikozisë. Me vete morëm edhe antikat e Dhrakos, koburen dhe jataganin e tij. Nëna ime i futi te depoja mbi banjë. Që të mos luaja me armë, meqë isha djalë i vogël. Çfarë isha unë, bandit isha dhe unë? Atë kohë nëna filloi punë në një kompani sigurimesh, punë zyre. Paga ishte e ulët, me vështirësi kalonim muajin, por ia dilnim mbanë. Gjatë muajve të verës punoja edhe unë, shpërndaja fletushka nëpër rrugë, punoja nëpër supermarkete, punoja dhe si kamerier. Kur nuk kishim nga t'ia mbanim, tërhiqnim të holla nga Banka Popullore. Miqtë dhe të njohurit e tim eti, të afërmit, të gjithë, na kthyen shpinën. Të gjithë. Në të vërtetë, nuk prisnim dhe shumë prej tyre. Secili interesohej për veten e vet, nuk u tepronte koha për ne, ndoshta edhe ata po vuanin ashtu si ne.

Kështu kaluan vitet, mbarova shkollën dhe fitova të drejtën për të studiuar në Fakultetin e Filozofisë. Dhe ja, tani jam student. Në vit të fundit. Me të mirë e me të keq, arritëm deri këtu. Derisa dhjetorin e kaluar, në prag të Krishtlindjeve, nëna ime humbi punën. Kompania largoi nga puna një pjesë të personelit. Aktivitetit i tyre u tkurr së tepërmi. Ashtu thanë.

Dhe më e keqja, në mars, pasoi qethja e depozitave në Bankën Popullore. Vendim i Brukselit. Eurogroupit. Sa hap e mbyll sytë depozitat tona u bllokuan. Derisa të bëhet shlyerja, nuk kemi mundësi të prekim paratë tona. Prit gomar të mbijë bar. I hëngrën paratë maskarenjtë. Bashkë i hëngrëm? E ç'u duhen luftërat, ç'u duhen armët? *Money talks!*

Më mori nëna në telefon që pa gdhirë në Athinë. Qante. Pothuajse nuk mund të fliste. M'u kujtua dita kur humbëm tim atë, dita që po linim shtëpinë tonë. "Mbaroi gjithçka, bir!", më tha. "Kjo është goditja vdekjeprurëse." M'u kujtuan vrasjet masive që bënin nazistët, ekzekutimet në grup gjatë vitit 1974. Dhe goditjet fatale mbi trupat e shtrirë. Jo, askush të mos jetojë! Nuk kishte më të holla që të paguante për studimet e mia. Erdhi fundi. Më duhej të lija garsonierën. Do të përpiquej të merrte hua ca pará deri në verë. "Për fat të mirë", më tha, "je në vit të fundit. Në korrik do të mbarosh dhe do të kthehesh në Qipro." Për fat të mirë. Për studime pasuniversitare as që bëhej fjalë. Ajo e di se sa më pëlqen të studioj për histori. Por, sipas vendit edhe kuvendi. Do të tregohesha i padrejtë me të. Si do t'ia dalim mbanë? Në fillim më privuan nga babai im, nga lumturia ime, pastaj nga shtëpia dhe tani nga ëndrrat e mia. Po ata bataçinjtë, po ata fundërrina. Gjithmonë e njëjta gjë. Të njëjtat marrëveshje të fshehta. Bankierë, politikanë, financierë, bosët e tyre jashtë shtetit. FMN-ja, BE-ja, shoqëritë shumëkombëshe, institucionet ekonomiko-financiare. Banditë dhe kryebanditë. Urrejtje! Urrejtja brenda meje u bë bishë. Hakmarrja m'u kthye në një ide fikse.

14/B3

Universiteti ishte vendi i veprimtarisë së përditshme të Serjidhit. Përgatitje, dhënie leksionesh, korrigjime, detyra administrative, kërkime në arkiv, mbikëqyrje e studentëve që kryejnë studime pasuniversitare, shkrime të ndryshme... Diku aty brenda ndrydhi edhe jetën e tij personale. Dhe nuk ishte aq keq. I pëlqente.

Kishte popullaritet te studentët e tij. Salla në formë amfiteatri ku ai jepte leksione, ishte gjithmonë plot. Një yll akademik që çdo herë jep shfaqje. Ishte e sigurt që me të nuk mërzhiteshin. Me kolegët nuk shoqërohej dhe aq. Marrëdhënie të kufizuara, brenda kuadrit të bashkëpunimit profesional. Ndoshta u shmangej, ndoshta i shmangeshin.

Ndërkohë, ishte dikush të cilin e admironte jashtëzakonisht shumë: mentori i tij akademik. Arkeologu i famshëm Jorgos Dhukarelis ishte një personalitet me autoritet që e vlerësonte jo vetëm komuniteti akademik, por edhe shoqëria. Kur Serjidhi sapo po niste karrierën e tij akademike, një tragjedi goditi jetën personale të Dhukarelit. Dhe, madje, në momentin kur vlerësimi profesional për të kishte arritur kulmin. Njeriu që zbuloi në Kufonisi skeletin e gruas së periudhës prehistorike, ai që e kishte çuar disa hapa përpara arkeologjinë e qytetërimit të Cikladeve, humbi bashkëshorten në një mënyrë të frikshme. Një vrasje makabër nga një paranojak. Në atë periudhë nuk e njihte Dhukarelin. Kishte lexuar për të në gazeta, kishte ndjekur intervistat e tij për zbulimin e rëndësishëm, por nuk e njihte personalisht. Por, ndërkohë,

ishite ndoshta një solidaritet mes kolegësh, një detyrim, apo një dhembshuri më e thellë njerëzore, që e shtynë të merrte pjesë në varrim dhe ta ngushëllonte nga afër. Kur ishin në kishë, e vuri re se sa i dërrmuar ishte. Me vështrim të humbur, me sy të skuqur, me flokë të thinjur, me mjekër të parruar, veshur me kostum të zi. Megjithatë, trupdrejtë dhe me qëndrim dinjitoz. Në krah të tij, e strukur në prehrin e një gruaje të panjohur, sigurisht ndonjë e afërme, qëndronte e bija, studente për histori në Universitetin e Selanikut. Fshinte lotët me një shami, lejonte që herë pas here t'i shpëtonte ndonjë gulçimë dhe ia fillonte përsëri nga e para.

Serjidhi vështronte grumbullin e njerëzve përreth. Pa shumë kolegë të tij nga universiteti. Priti në radhë me durim dhe, kur iu afrua, i bëri përshtypje fytyra e zbehtë, pothuajse e verdhë e Dhukarelit, të plakur para kohe, dora e tij e ngrirë. E vështroi drejt e në sy. “Ngushëllimet e mia të sinqerta, zoti Dhukareli”, belbëzoi. Ai e falënderoi dhe për habi i foli në mbiemër. Nuk e besonte. Ata të dy nuk kishin shkëmbyer kurrë asnjë fjalë, rrugët e tyre nuk ishin takuar asnjëherë. Një apo dy herë e kishte parë tek çapitej për te amfiteatri, t'i ngjiste shkallët me ngadalë. Kjo ishte e gjitha. Por ja që Dhukareli e njihte, i dinte emrin.

Kur Dhukareli, pas përfundimit të lejes u kthye në universitet, patën rastin të takoheshin dhe të bisedonin. Serjidhi e vlerësonte jashtë mase, Dhukareli ishte njeri me integritet. Shumë herë kishte refuzuar me modesti propozime të partive politike për të qenë kandidat për deputet i tyre. Në qeverisjen e fundit, gjatë një riformatimi të kabinetit, emri i tij u diskutua si kandidat për postin e ministrit të Kulturës. Ose ai vetë ua preu një herë e mirë, ose ata nuk e shtynë më tutje atë histori, por Dhukareli i mbeti besnik shkencës dhe parimeve të veta. Sigurisht që ndër miqtë e tij kishte dhe politikanë, por siç përsëriste shpesh, ai që bëhet me

mjaltë, e hanë mizat. Nuk donte të zhgërryhej në baltën e politikës, në llumin e partive, siç i quante ai ato strofuj korrupsioni. Madje, edhe tani që po i afrohej fundit të karrierës, kishte mbetur ende një shpirt i trazuar. Veç programit të ngarkuar që kishte në universitet, bënte plane për gjurmime të reja, shkruante libra, punonte për ngritjen e një muzeu të ri, modern, pararojë të artit cikladik në Kufonisi. Që do të strehonte, veç të tjerave, edhe atë skelet, atë simbol, të gruas prehistorike, Kasiopesë. “Dua që jeta ime të mbarojë duke gjermuar. Midis eshtrave të zverdhura dhe objekteve të tjera me vlerë që shoqëronin të vdekurit në varr”, përsëriste shpesh duke buzëqeshur. E thoshte me shaka... apo e kishte me të vërtetë... asnjëri nuk e dinte.

Po, ishte e vërtetë, Dhukareli e njihte. Dëgjonte gjatë verës studentët e tij kur bënin gjurmime, nën qiellin plot me yje buzë detit, të flisnin me admirim për të. Për popullaritetin e tij, për leksionet interesante që jepte, për energjinë e tij të pashtershme, për sallën mbushur plot e përplot kur fliste ai. Dikush ia tregoi me gishtin tregues të dorës së tij. “Ja, ai është Serjidhis, për të cilin ju flisja, zoti profesor.” U kthye dhe e vështroi. Veshja e tij e thjeshtë, por e trajtuar me kujdes dhe elegante, flokët e shtruar që kishin filluar të rralloheshin aty-këtu. Serjidhis kishte personalitet. Ishte një personalitet.

Dhe një ditë, një ditë që diskutohej në Komisionin e Posaçëm të Senatit mbi ecurinë e tij profesionale në universitet, Dhukareli nguli këmbë i vendosur dhe i ra tavolinës me grusht. Të mos guxojnë të privojnë një “pedagog karizmatik”, siç e quajti ai, nga e drejta e karrierës akademike. Dhe shtoi se kjo do të ishte në favor të universitetit. Në këtë mënyrë, pikëpamja e tij me peshë, personaliteti i tij, bëri që balanca të kthehej në favor të Serjidhit. Planet e shefit të Departamentit të Historisë, ndoshta nga smira, apo ndoshta për t’i bërë nder ndonjë njeriu të vet, u futën në frigorifer. Përkohësisht.

Serjidhi nuk e dinte atëherë se gradën ia kishte borxh Dhukarelit. As Dhukareli nuk i tha gjë, madje edhe atëherë kur, pas varrimit, mes tyre filloi të ndërtohet një marrëdhënie reciproke konsiderate dhe miqësie. E mori vesh disa vite më vonë nga një koleg i tij që kishte marrë pjesë në atë mbledhje me rëndësi vendimtare për të ardhmen e tij. Po, nuk e dinte. Dhe si budalla, kur iu komunikua vendimi për gradën që mori, shpejtoi të takonte shefin e Departamentit, t'i shtrëngonte dorën me mirënjohje, ta falënderonte ngrohtësisht për kontributin e tij personal. Siç besonte ai. Dhe ai e vështroi i habitur, kishte mbetur paksa si guhak, “përgëzime, zoti koleg”, i tha ftohtë, diçka pëshpëriti, uli kokën dhe pastaj ngriti receptorin duke formuar një numër, shenjë kjo se duhej t'i zhdukej nga sytë dhe nga zyra.

Po, Serjidhi duhej t'ia dinte për nder Dhukarelit. Ishte mentori i tij, pavarësisht se u përkisnin degëve të ndryshme, me objekte të ndryshme studimi: arkeologji prehistorike njëri, histori moderne greke tjetri. Gradualisht, midis tyre u krijua njëfarë intimiteti, u hodhën themelet për një miqësi të sinqertë dhe jo të shtirur. Serjidhi kalonte shpesh nga zyra e tij në katin e dytë për t'u këshilluar me të për çështje që kishin të bënin me jetën universitare, pengesat, prapaskenat e kolegëve të tij, temat që kishte për të zhvilluar në leksionet jashtë shtetit, ndonjëherë dhe raportin midis arkeologjisë së shekullit të 19-të me interesat e veta kërkimore historike. Diskutonin, bile, edhe për çështjet e tyre personale. Rrinin ulur nëpër kolltukë dhe diskutonin këmbëkryq, duke tymosur, Dhukareli me llullën dhe duhanin e përzgjedhur *Berlei* nga Kentaki, ndërsa Serjidhi, cigaret e veta me duhan të lehtë. Dhukareli i hapte zemrën dhe i fliste për merakun që kishte për Isminin, të bijën, për karrierën e saj universitare që sapo kishte filluar në Bruksel, për një lidhje që kishte, e cila u ndërpre papritur para pak muajsh, dhe që e dëshpëroi shumë. Edhe ai i fliste për të vëllain në Angli, për të atin, për nënën dhe për ankthin që ajo

kishte që ta “martonte”, domethënë... që t’i gjente nuse. Dhukareli qeshte. “Ka të drejtë nëna jote. Beqar i staxhionuar do të mbetesh?”

Edhe sot, po ashtu, Serjidhi trokiti në derën e zyrës së Dhukarelit. Ndjeu aromën e njohur të duhanit që kishte depërtuar pajisjet, mobilet, muret e zyrës së tij. Vanilje, qershi. Ndoshta dhe të dyja. “A ke pesë minuta kohë të lirë, Jorgo?”

“Urdhëro brenda, ulu”, iu përgjigj.

Në atë re tymi që po ngjitej lart, Serjidhi e informoi për takimin që kishte pasur me shefin e Departamentit të tij. E kishte thirrur për t’i hequr vërejtje. E denoncyan kolegë dashamirës ngaqë kishte varur në dërrasë fotografi të viktimave në demonstratën e madhe të 5 Majit dhe të “politikanëve të shitur”.

“Nuk bëjmë politikë, as predikojmë në sallën e leksioneve, zoti Serjidhi, edhe nëse... edhe nëse zhvleftësojmë politikën dhe politikanët. Dhe, tekefundit, ku është parë e dëgjuar një titull i tillë në leksion universiteti? *Politikë, politikanë, banditizëm dhe terrorizëm!* Ç’janë këto gjëra? Çfarë roli po luani, zoti Serjidhi?”

Dhukareli nxori tymin e duhanit dhe qeshi me gjithë zemër. “Kështu, ë...”

“Po tani, çfarë duhet të bëj, sipas mendimit tënd, Jorgo?”

“Ti? Asgjë. Mos u shqetëso. Akoma nuk i ke njohur? Nuk je dhe aq i ri këtu. Harroje. Mos i jep rëndësi. Por për semestrin tjetër, për mirë apo për keq, ndryshoje titullin, që të qetësohet dhe zoti shef. Vëri, për shembull, titullin: *Politikanë, banditë dhe batakçinjtë të tjerë*”. Ia shkrepri përsëri të qeshurës. “Jo, po flas seriozisht tani, ndryshoje titullin, por mbaj siç është përmbajtjen e leksionit tënd.” Tym i lehtë dhe i bardhë po ia mbulonte fytyrën.

Serjidhi buzëqeshi.

“Ashtu do të bëj”, i tha, dhe pasi shoi cigaren te tavlla e duhanit, doli. Mori frymë thellë. “Ashtu do të bëj.”

Politikë, politikanë, banditizëm dhe terrorizëm. Ky ishte titulli i leksionit të historisë që përzgjodha për semestrin e dytë, atë të pranverës. Ngjante si parullë e demonstratave të kuqe apo mbishkrim me shkronja të zeza në ndonjë prej mureve të qytetit. “Jam një historian heretik. Nuk ndjek traditën”, na tha Romanos Serjidhis, pedagogu i historisë. Ishin fjalët e tij të para. Leksioni i tij i parë. Sapo kishte vendosur çantën e tij mbi katedër. U kthye drejt sallës në formë amfiteatri të leksioneve, të mbushur plot, dhe filloi: “Prandaj më urrejnë politikanët. Edhe banditët. Ah, se harrova! Edhe historianët...”.

Pas çdo fraze që shqiptonte, në sallë dëgjoheshin të qeshura. Më kishin folur për të studentë të viteve të kaluara, qipriotë. “Duhet ta përzgjedhësh këtë lëndë, patjetër. Do t’ia kalosh mirë.” Kishin të drejtë. Ia kalova shumë mirë në lëndën e tij, shkëlqyeshëm. Por nuk ishte thjesht argëtuese lënda e tij, jo, nuk e zgjodha vetëm për këtë.

Serjidhis ishte pedagog dhe bashkëbisedues karizmatik, por kishte aftësinë, edhe maninë, të merrej me çështje që devijonin nga historia zyrtare, çështje relativisht margjinale, heretike, ashtu siç i quante vetë, të guximshme, që qëndronin mbi një litar të tendosur, midis ngjarjeve reale dhe hamendësimeve të pacaktuara, por logjike. Kështu që, kur lexova në programin e studimeve ciklet e leksioneve të tij, sidomos *Masakrën e Dhilesit*, e kisha marrë ndërkohë vendimin tim.

Serjidhi ishte ai që më hapi sytë. Dhe marr guximin të them se nëse universitetet do të kishin dhe pedagogë të tjerë si ai, shoqëria

greke do të ishte ndryshe. Po, ishte njeriu që më dha çelësin për të kuptuar të gjitha ato që po ndodhnin rreth meje. Të vendos në radhë gjithçka që kishte zënë vend në mënyrë të çrregullt, të pakuptimtë dhe pa lidhje në mendjen time. Duke gërmuar në të kaluarën, e kuptoja më mirë të tashmen. Në këtë kuptim, ai nuk ishte një mësues i thjeshtë, ishte ajo çka i duhet çdo nxënësi: një udhëheqës në jetën e vet.

Lënda e tij ishte një aventurë e vërtetë. Mobilizonte një shumëllojshmëri të pashtershme metodash, shumë herë të paparashikuara, humori, drame, surprizash, ngjarjesh të çuditshme dhe të pazakonta, pothuajse të pamundura dhe jashtë logjike që, nga njëra anë, kishin si qëllim të mbështesnin teoritë e tij dhe, nga ana tjetër, të zgjonin interesimin tonë, të na ngacmonin. Po, Serjidhi në katedër ishte një aktor në skenën e teatrit, ishte protagonist, aktori i parë, i aftë për role komike, akoma më i aftë për role dramatike. Gjithmonë ishte bindës.

Shpeshherë përsëriste se të gjitha të këqijat që u grumbulluan në ditët tona, lidheshin në mënyrë të pazgjidhshme me probleme të institucioneve dhe të strukturës së shtetit, të krijuara që në kohën e Pavarësisë dhe të krijimit të shtetit. “Ka qenë dhe është një shtet problematik. Sepse një shtet i tillë u intereson oxhakëve, faktorëve politikë dhe ekonomikë, vendas dhe të huaj - kryesisht faktorëve ekonomikë. Fuqitë e Mëdha përdornin garancitë për integritetin, pavarësinë dhe rendin mbretëror në Protokollin e Pavarësisë të vitit 1830, si një pretekst për të ndërhyrë në punët e brendshme të vendit”, përsëriste herë pas here. I mbaronte leksionet duke përsëritur: “Dhe mos harroni, banditët i kanë lënë tashmë malet, kanë zbritur në qytete”, një përshtatje e thënies së kryebanditit Jankulla. Dhe duke e dëgjuar, kisha ndjesinë, kisha bindjen e fshehtë, se Serjidhi na shtynte, në ndërdijen tonë, drejt reagimit

dhe rebelimit social kundër establishmentit, kundër gjithë atyre që kishin kaq vite që plaçkitnin dhe shfrytëzonin vendin.

Pikënisje e leksioneve të tij ishin patogjenezat e shtetit grek që stimuluan lindjen dhe forcimin e fenomenit të banditizmit: njësitë e çrregullta të luftëtarëve që u përndoqën egërsisht nga regjenca e Armansbergut dhe në vazhdim nga mbreti Othon, korrupsioni politik dhe marrëdhëniet klienteliste lindin prej tij, lakmia për kryetarllëk dhe pushtet të koxhabashëve të vjetër partiakë, që ua kishin nevojën banditëve dhe bandave të tyre në zonat e tyre zgjedhore për të trembur kundërshtarët politikë dhe për të fituar vetë në garat elektorale. Ishte, gjithashtu, politika irredentiste e qeverive greke, që shfrytëzonin bandat e zonave kufitare, matanë kufijve, në brendësi të Greqisë, që në atë kohë ishte akoma nën pushtimin turk, tradita që kishte në Greqi, lëvizja e *kleftëve* dhe armatolëve, politika e egër fiskale kundër bujqve dhe blegtorëve, arbitrariteti në kurriz të tyre nga ana e autoriteteve vendore dhe e njëjse lëvizëse të luftës kundër banditizmit, paaftësia e organeve ligjzbatuese, tradita e mosdënimit dhe amnistitë e shpeshta në favor të banditëve, të cilët shpesh inkuadroheshin dhe në forcat e policisë.

Na fliste për bandat e mëdha dhe kryebanditët demoniakë, për Davelin, Kalaballikin, për Spanonë, për Arvanitakët, për aktivitetin e tyre në zonat kufitare, apo, madje, edhe në Atikë, për bëmat e tyre, për pengmarrjet dhe haraçet që kërkonin për lirimin e pengjeve, për taksat që u vendosnin banorëve të zonave rurale, për përndjekjen nga njësitë e xhandarmërisë, për lidhjet që kishin me kryengritjet në zonat e okupuara dhe për amnistitë, për rrjetin e bashkëpunëtorëve të tyre, për ata të cilët përfundonte plaçka e vjedhur, për barinj të dhe për pronarët e kopeve të mëdha, për vëllamët, për përbërjen e bandave që kryesonin, për veshjen, për armatimin, për zakonet, për kodin e nderit dhe të sjelljes së tyre,

për aleancat me politikanë që inkurajonin banditizmin, me të cilët shpesh bëheshin kumbarë. Sidomos për këta lloj politikanësh, na fliste më hollësisht.

Serjidhi u jepte rëndësi ngjarjeve konkrete për të mbështetur pikëpamjen e tij mbi bashkëpunimin e banditëve me politikanët. Të tilla ishin, pjesëmarrja e bandave në përplasjet e përgjakshme civile në Athinë gjatë qershorit të vitit 1863, midis “Malësorëve” dhe “Fushorëve”, që njihen si ngjarjet e qershorit, rrëmbimet e herëpashershme të figurave politike nëpër krahinat e vendit, Masakra në Dhilesi. I bënte më të besueshme këto argumente duke iu referuar shumë burimeve: burimeve primare të arkivave, procesverbaleve të Dhomës së Lordëve dhe të Dhomës së Komunave të Parlamentit Anglez, procesverbaleve të Parlamentit Grek, Arkivave Qendrore të Shtetit dhe Arkivit Historik të Ministrisë së Jashtme, deponime të banditëve të arrestuar, raporte të komandantëve të njësisë të ndjekjes, raporte gjyqtarësh dhe përfaqësuesish vendorë me rekomandime për qeverinë qendrore, dëshmi të njerëzve që u mbajtën peng, ditarit të lordit *Mankaster Ransom and Murder in Greece*, librit *The Dilesi Murders* të Romilly Jenkins-it, artikuj të kohës nga gazetata angleze dhe greke. Shpesh i koordinonte me artikuj të kohës së sotme për politikanët pehlivanë, për ryshfetet për shërbimet klienteliste, për korrupsionin, me artikuj për deklaratat e kryeministrit dhe të shefit të opozitës, nga të cilat, duke i deshifruar, siç pretendonte, nxirrte kuptimin e vërtetë. Ashtu siç bëri në periudhën mes dy luftërave Bertold Brecht me tekstet propagandistike dhe gjuhën e pushtetit në fjalimet demagogjike të Gëbelsit dhe të Hitlerit. Shumë herë Serjidhi u referohej tregimeve popullore të asaj periudhe, pamfletit *Pikëpamje të një banditi ose dënimi i shoqërisë* të D. Paparigopulosit, poemës *I biri i xhelatit, poemë historike* e Al. Katakuzinusë, poemave të E. Empirikos *Rruga* dhe të G. Paraskos

Mallkimi kombëtar, u referohej këngëve të banditëve apo dhe romaneve, si p.sh *Thanos Vlekas* i Pavllo Kaligës, *Mbretit të kreshtave*, të Edmont Abusë, *Jeta ushtarake në Greqi*, *Banditët në rrethinat e Athinës*, të Karagaçit, *Heremiti i çmendur* i Llambro Enialit.

Dhe, të gjitha këto, për të arritur në konkluzionin: “Kujtoni se në shekullin e 19-të banditizmi u zhduk? Nëse besoni se u zhduk, gaboheni”. Pauzë. Serjidhi rrinte duke na vështruar. Heshtje për disa sekonda. Qëndronte aty, përpara katedrës, i ngurosur. Një fosil. Bebet e syve të tij lëviznin ngadalë majtas, djathtas, duke mbuluar të gjithë auditorin në sallën-amfiteatër. Pastaj një frymëmarrje e thellë, dhe gjallërohej përsëri. “Ekziston edhe sot e kësaj dite dhe vërteton thënien e Jankullës, kryebanditit të periudhës mes dy luftërave: *Do të vijë një ditë që banditët do t'i lënë malet dhe do të zbresin nëpër qytete*. Banditët rrojnë dhe mbretërojnë, si Haxhistavro i Abusë, si Taso i Kaligës. Shikoni se në ç'gjendje e katandisën vendin. U deshën dyqind vjet që të na sjellin këtu ku jemi. Gjithmonë të njëjtët ujqër të maskuar si qengja. Për çdo parti dhe një kryebandit me trimat e tij, me të afërmit, me kumbarët, vëllamët, me pronarët e kopeve të mëdha, me vathën, me personat ku shkon plaçka e vjedhur. Me ryshfetet, me gjobat, me paratë e pista. Ndonjëherë ndërtojnë dhe ndonjë kishë, siç bënte çdo bandit i mirë në kohën e banditizmit, për t'u hedhur hi syve njerëzve, apo e bëjnë ngaqë besojnë me të vërtetë në shpëtimin e shpirtit të tyre. Ua kanë nevojën interesat e huaja politike dhe ekonomike, ata që kërcënojnë herë pas here, ata që në fakt kontrollojnë vendin. Janë prokrustët, pitiokambtët dhe skironët e kohës së sotme. Një pjesë, ndoshta më e madhja prej plaçkës, përfundon tek ata. Merreni vesh. Politika sot është industria e banditizmit të kamufluar. *Bashkë i hëngrëm?*”

Erdhi një ditë vere, pasdite vonë, pas pune. Na gjeti te kioska prej druri. Trëndafilat lëshonin aromën e tyre dehëse në atë ambient me lagështi. Nëna ime rrinte në karrigen lëkundëse dhe lexonte. *Këngën e Solomonit*, të autores Toni Morrison. Unë luaja me një lodër elektronike, *Game Boy*. Larg, në rrugën automobilistike, u dëgjua një buri e fortë, e zgjatur, si dhe frenat e një automjeti.

“Prapë ato fantazira po lexon”, u përpoq ta ngacmonte. Kështu i quante romanet, letërsinë: trille, fantazira.

Po, herë ironizonte letërsinë, dhe herë të tjera mundohej ta irritonte. Nëna ime, megjithëse dukej e irrituar, në fakt nënqeshte. Por vetëm kaq. Biseda nuk vazhdonte më tutje. Për të, letërsia ishte një grumbull gënjeshtresh të vëna në radhë që u prishte mendjen njerëzve. Letërsia është për të çekuilibruarit dhe për ata që nuk kanë punë për të bërë. Letrarët janë sharlatanët, batakçinjtë e fjalëve, mashtruesit. Magjistarët që pëshpëritin fjalë, yshtje magjike, psalme të pakuptimta, për të mashtruar naivët. Për tim atë, libra të vërtetë ishin ato të tijat: botimet e çmuara për gjeologjinë, për botanikën, për entomologjinë. Ato po, ato ishin shkencë.

Nëna nuk iu përgjigj. Por këtë herë, krejt papritur, mbylli librin në mënyrë demonstrative - *tap!* - u ngrit dhe u largua. E la aty të shtangur në vend, të zhytur në heshtjen e vet. Ai më hodhi një vështrim prej fajtori, zgjati dorën i pavendosur dhe më ledhatoi flokët. Nuk gjeti ndonjë gjë për të më thënë. E shikoja që po hante

Emilios Solomou

veten me dhëmbë. Psherëtiu. Dhe pas një minute ishte larguar. Vajti brenda në shtëpi për ta gjetur. Nuk e di se çfarë biseduan mes tyre. Por në darkë, në tavolinë, ishin pajtuar ndërkohë.

Po, im atë nuk kishte ndonjë konsideratë për letërsinë. Por, ndërkohë, ama, këtë pikëpamje tashmë do ta mbante vetëm për vete.

Gjysmën e asaj dite e kaloi në hotel. Te skena e krimit. U kërkoi drejtuesve të hotelit listën me emrat e klientëve. Dërgoi njerëzit e tij nga dhoma në dhomë për të pyetur. Nëse panë apo dëgjuan diçka të çuditshme? Madje i urdhëroi të ushtronin kontroll të hollësishëm në të gjithë zonën përreth. Mori vesh se natën e kaluar makinat e bashkisë nuk kishin pasur radhën për mbledhjen e mbeturinave. I vuri të kontrollonin kazanët e plehrave, si ata mbledhësit e kanoçeve dhe lypsarët që kërkojnë nëpër mbeturina. Zakonisht, gjëja e parë që bëjnë vrasësit është të flakin çdo gjë që mund të shërbejë si provë e implikimit të tyre. Ai vetë u ngjiti në suitë, në katin e njëmbëdhjetë. Që herët në mëngjes. Para se të vinte ekipi dhe të fillonte punën për pastrimin e dhomës. Sigurisht që trupat ishin zhvendosur, ishin në morg për t’iu nënshtruar autopsisë nga mjeku ligjor. Por gjurmët e asaj masakre të tmerrshme ishin akoma aty, në çdo cep. Pika gjaku të thara, njolla gjaku të mpiksur, inde të trupave në parket, në mobilie, në televizor. Gjatë gjithë mbrëmjes ekspertët mblidhnin prova. Laboratori i Policisë Greke do të punonte gjithë natën.

E shoqëronte përgjegjësi i hotelit. Ai theksoi se, sipas të gjitha gjasave, autorët e krimit i ngjiten me këmbë të paktën disa kate. Nga kati i shtatë e lart, vetëm viktimat e kishin çelësin e ashensorit. Donte t’i ngjiste shkallët deri në katin e njëmbëdhjetë. “Me siguri që po bëni shaka, zoti inspektor”, i tha. “Aspak”, iu përgjigj Apostollu. Duhej të ecte në ato vende ku kaloi dhe vrasësi - apo ndoshta vrasësit? Sigurisht që ekspertët kishin kaluar edhe andej,

por kurrë nuk i dihet. Gjithsesi, duhej të krijonte vetë një ide, donte të kishte një pamje të plotë në mendjen e vet, të plotësonte boshllëqet midis presjeve, pikave dhe pikëpyetjeve. U ngjitën me këmbë deri në katin e njëmbëdhjetë. Përgjegjësi i hotelit më në fund e shoqëroi, por kur po mbaronin së ngjitur, filloi të kollitej, i filloi një kollë që nuk i pushonte. Vuri dorën në gjoks. Nuk ndihej mirë. U përkul më dysh dhe ndenji për pak i mbështetur te gjunjët. Mërmëriti diçka duke marrë frymë me vështirësi, diçka për mjek, se duhej të bënte testin e lodhjes, biçikletën që thonë, diçka e tillë. Pastaj ia plasi të qeshurës. Tani në pleqëri të ngjiste dyqind e pesëdhjetë shkallë? Si e bëri këtë? “Kam bërë shumë për ju, zoti inspektor.” Midis katit të dhjetë dhe të njëmbëdhjetë, panë gjakun e policit që u vra. Linoleumi ishte akoma me njolla. Me gjak të zi. Të errët.

Apostollu kaloi përgjatë gjithë korridoreve, në katin përdhes, te hyrja nga futej personeli, duke kërkuar prova, fakte, një çelës për zgjidhjen e gjithë kësaj enigme. Ishte i shqetësuar. Autopsia që bëri mjeku ligjor nuk tregoi asgjë më shumë se ato që dinte, të dukshmet. Hollësira që nuk i hynin në punë. Diçka nuk shkonte, diçka mungonte në gjithë këtë histori. Trupat kishin gjurmë baruti nëpër rroba, shenjë kjo që tregonte se u qëlluan në distancë fare të afërt. Ekspertët e kriminalistikës morën gjurmë gishtërinjsh me anë të pluhurit magnetik ngjyrë gri nga muret, dyert, lavamani, pasqyra. Të gjitha gjurmët ishin të viktimave dhe të punonjësve të personelit të hotelit, të cilët u morën në pyetje, por nuk rezultoi asgjë që t’i inkriminonte. Shenja gishtërinjsh të vrasësit nuk u gjetën asgjëkund. Të gjitha pikat e gjakut, gjithashtu, u përkisnin viktimave, asnjë nuk ishte e autorëve. Nuk kishte asnjë shenjë që të tregonte se para vrasjes pati përlëshje. Asnjë nga kamerat e hotelit nuk regjistroi ndonjë person të dyshimtë. Në mënyrë

paradoksale, sistemi elektronik i vëzhgimit ishte jashtë funksionit, ishte i bllokuar në atë moment, në momentin që sipas mjekut ligjor vrasësit shkrepën armët dhe tehu i thikës preu trupat. Një fantazmë duhej të ishte futur në hotel dhe të kishte dalë një hije.

Informacioni i vetëm që ndoshta do të ndihmonte, ishte deponimi i rojës në hyrje të hotelit. Ai, në deponimin e tij, përshkroi një burrë që u largua me nxitim nga hoteli. Ishte rreth dyzet vjeç, 1,75 apo 1,80 metra i gjatë. Dukej disi i shqetësuar. Pak më vonë u dha alarmi. Gjatë marrjes në pyetje, roja tha se nuk ishte i sigurt se çfarë kishte veshur, nuk e mbante mend, ndoshta një xhaketë ngjyrë bezhë dhe pantallona kadife. Por tiparet e fytyrës i mbante mend, po, ishte i sigurt për këtë. E mbante mend. Paksa i mbushur, faqet pakëz të fryra, kokën të rruar, sy ngjyrë jeshile të errët, buzë të trasha dhe hundë të trashë.

Analiza balistike tregoi se arma e vrasjes ishte një *Glock 17*, një tip pistolete e zakonshme, që në të kaluarën ishte përdorur nga organizata terroriste në Greqi. Tregoi gjithashtu se e njëjta pistoletë *Glock 17* ishte përdorur përsëri në një grabitje ordinere në Greqinë e Veriut, në Katerini, para dy vjetësh. Autori kishte qëlluar atëherë lart në tavanin e një furre buke, që të frikësonte shitësen dhe t'i dorëzonte atij paratë që ishin në arkë. Mori njëqind euro dhe u zhduk. Çështja ishte mbyllur, autori ishte zhdukur, policia nuk merrej me vogëlsira të tilla. Por ja që tani ajo grabitje doli përsëri në skenë. Dhe Apostollu, me urdhër urgjent të Drejtorisë së Përgjithshme, i kërkoi Drejtorisë së Policisë në Katerini që të rihapte çështjen. Për çdo eventualitet dërgoi nëntogerin e policisë, Ektorudhin, të shqyrtonte edhe një herë çështjen. Po, vërtet, si do t'i gjendej filli asaj historie?

Në mbledhjen që u thirr në drekë në sallën operacionale për shqyrtimin e gjendjes, ku i pranishëm ishte edhe nëndrejtori

i Përgjithshëm, disa pretendonin se mbrapa vrasjeve ndoshta fshiheshin elemente të ekstremit të djathtë dhe se në favor të kësaj hipoteze fliste edhe shënimi që u gjend në skenën e krimit, që mbante datën 21 prill 2013. *Një aludim i qartë për “vitin e shpëtimit të kombit”*. Ithtarë të ekstremit të djathtë kishin bërë në të kaluarën kërcënime kundër Trojkës, të cilën e konsideronin “fuqi pushtuese”. Sigurisht që përzgjedhja e asaj date, në kuptimin e simbolikës që mbartte, nuk ishte e rastësishme.

Një prej policëve bëri lidhjen e shprehjes “ashtu dua u” me elemente keqbërëse shqiptare. “Duhej ta kishin parasysh edhe këtë mundësi”, tha ai. Po ajo tjetra: “Jorgaqi e bëri këtë?”. Mos ndoshta ishte kërcënuar ish-kryeministri kohët e fundit? Ndoshta e konsideronin përgjegjës për gjithë këtë që po ndodhte. Ishin të shumtë ata që e ngarkonin me përgjegjësi për memorandumun dhe futjen e vendit nën kontrollin e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Ishte vepër e tij.

Apostollu nuk dinte çfarë të besonte. Pas një krimi, gjithmonë fshihen shumë të tjerë. Gjithçka ishte nën hetim, asnjë variant nuk mund të përjashtohej. Ndoshta ishte me të vërtetë vepër e qarqeve të ekstremit të djathtë, ndoshta e ndonjë organizate terroriste. Gjithçka ishte fluide.

Hetimet u zgjeruan në të gjitha drejtimet: te nëpunësit e hotelit, te bota e nëndheshme e krimit, te qarqet e marginalizuara, te grupet me tendenca antipushtet, te grupe të ekstremit të djathtë dhe të ekstremit të majtë. Ishte një labirint dhe atij i duhej të gjente rrugëdalje.

Një informacion i ri që mbërriti gjatë pasdites, e ngriti moralin e grupit të hetimit: në sistemin elektronik, që regjistronte hyrjet dhe daljet e nëpunësve të hotelit, ishte regjistruar dhe emri i një shërbyesi që ishte pushuar para disa muajsh. Të njëfarë

Sevastopullos. Apostollu, ndërkohë, e dinte që autori nuk mund të dilte kaq zbuluar. Nëpunësi që fut kartën në aparat dhe jep të dhënat e identitetit, nuk kryen vrasje. Kur personin në fjalë e sollën në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë për Atikën, sapo e pa, as që mori mundimin për të qenë vetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje. Ishte një gjysmë njeriu, i dobët, anemik, që dridhej teksa e çonin për të deponuar dhe vështronte përreth me sytë të zgurdulluar. Jo, nuk mund të ishte ai. Policët biseduan me njerëz të rrethit të tij të ngushtë. Nuk gjetën gjë. E përjashtuan si të dyshuar.

Apostollu mobilizoi ekspertë të informatikës, i vuri të bënin kërkime në bazën e të dhënave, në internet, për njoftime dhe mesazhe kërcënuese që dërgoheshin herë pas here kundër anëtarëve të Trojkës. Në formë shakaje, por dhe seriozisht. Punësoi ekspertë të telekomunikacioneve. Jo, nuk gjeti gjë. Rezultati ishte zero.

Kështu që, e vetmja gjë që mbetej në gjithë këtë gurgull ishte ajo skicë dhe ndoshta një mundësi e zbehtë që të dilte ndonjë informacion nga grabitja në Katerini. Me një fjalë, errësirë e thellë.

Apostollu ishte me të vërtetë në një situatë që nuk dinte se çfarë të bënte. Çështja kishte ngecur. Ishte i dekurajuar kur i erdhi nëndrejtori i përgjithshëm dhe e urdhëroi që për çdo informacion të ri të informonte menjëherë edhe Shërbimin Sekret. “Urdhër nga lart”, shtoi ai pa e shpjeguar atë *nga lart*. Pak më vonë ai priti në takim shefin e Shërbimit Sekret.

18/D3

[...]

Pyetje: - Çfarë di për çobanin vllah Kosta Selami?

Përgjigje: - Ai na furnizonte me bukë, me djathë dhe mish në Oropo. Takoja e dërgonte shpesh të merrte dhe të na sillte letra.

Pyetje: - Çfarë mund të na thoni për vizitën e Hristo Arvanitakit në Athinë para vrasjes?

Përgjigje: - Dy ditë pas Kifisiasë, Hristo ngriti prapë pretendime. Këtë radhë donte që të shkonte në Athinë. Fshati digjej dhe plaka krihej. Donte të shkonte, thoshte, të takonte dikë që ishte i pjacës, që ushtronte ndikim, shkëlqesia e tij, që firmoste dhe vuloste aty, njeriun e tij, me të cilin do të shpjegohej për punën e lordëve. Dhe sebepe të tjera të ngjashme. E vërteta ishte se u marros pas asaj ledit që pa atëherë në Varie, në Kifisia. Synonte të njihej me të. Takoja nuk e hëngri. Pse, budalla ishte ai? Apo i lajthitur? U zunë, bënë prapë fjalë. “Jo”, i tha, “nuk do ikësh përsëri”. Humbi shpresat. “Do të ta presin kokën si të gomarit dhe do ta bëjnë paçe për ta ngrënë”, i tha. Por ai u ngrit herët të dielën, lidhi një qese te brezi, të mbushur me të holla. Takoja ishte i shqetësuar dhe nuk flinte. T’ia fuste me shpatë, nuk e bëri. Ishte vëllai i vet, gjaku i tij. Jo, nuk e bëri. Por u ul dhe shkroi një letër për t’ia dhënë një kumbari të vet që kishte në Athinë. Unë nuk e di se kush është ky. E këshilloi përsëri të më merrte me vete, të shkonim bashkë, sepse vendi ishte me rrezik. Ai nuk kishte më besim tek unë, thoshte se ia tregova të gjitha Takos, edhe për

atë të huajën, ledin, për të cilën thoshte se ndiente për të dhe se e dashuronte. Arriti deri aty sa një mbrëmje nxori thikën dhe ma vuri në fyt që të më hiqte qafe. “Do të të ther, pizeveng!”, më tha. Por hyri në mes Takoja dhe ai uli dorën. Mori me vete Dhrakon, që t’i qëndronte afër. I shihnim që po na humbitnin nga sytë teksa largoheshin.

Pastaj Takoja dha urdhër, dërgoi pas tyre fshehtas spiunin, Selamin, njeri të sigurt, t’i bënte sytë katër, sepse e dinte që xhandarët zinin prita dhe kishte rrezik ta qëronin pabesisht.

Se çfarë bëri aty, i mësova më vonë, me hollësi, prej Dhrakos kur u kthyen. Në vathën e një çobani, të Tambaleksit, jashtë Athinës, u qethën dhe hoqën mjekrën, dhe ndryshuan pamjen duke veshur rroba allafërënga. Kështu, të veshur allafërënga, arritën në Athinë dhe qëndruan në një hotel brenda në qytet. Dy ditë silleshin rrugëve të Athinës. Hristo përpiquej të vishej e të mbahej në mënyrë sa më luksoze, kërkonte që të dukej, pavarësisht se Takoja e kishte porositur që të mos binte në sy.

Rrinte vazhdimisht në një kafe jashtë hotelit të ledit, ishte i shqetësuar, dhe priste që ajo të dilte për ta parë. Prishi mjaft të holla dhe i bleu edhe një stoli. Aty rrinin të dy me Dhrakon; vrisnin miza dhe pinin alkool gjithë ditën. Harxhonte paratë që mbante te brezi dhe vriste kohën te kaffja. Ndërsa ne aty, në limeret tona, mbanim lordët, bënim kujdes nga xhandarët dhe prisnim përgjigjen nga qeveria.

Nuk jam në dijeni nëse Hristo e takoi ledin. Dhrako ishte kërcënuar fshehtazi që të mos hapte gojë. Këto di, këto ju tregova. Di vetëm se Takoja rrinte si mbi gjemba dhe se ishte i zemëruar me shpërdorimet dhe sjelljen e të vëllait. Kishte divergjenca të mëdha mes tyre. Ai e dinte se çfarë bëri dhe çfarë nuk bëri Hristo në Athinë. I vinin informacione nga çirakët dhe spiunët e tij. [...]

19/D4

Dëgjonin varetë tek po godisnin. Hekurin mbi shkëmb. Dhe nën atë diell të shndritshëm panë punëtorët që ishin kacavjerrë te kodra e Likavitosë, me veglat e punës që shkëlqenin. Ecën shpejt në mënyrë që t'u shmangeshin. Sa më pak njerëz të takonin, aq më mirë ishte. Arritën në vendin e quajtur Kacikadhika, gjithë pluhur dhe të lodhur nga marshimi në këmbë. Pyetën dhe u treguan stanin e një çobani nga Lidhoriki, të Tambaleksit. Njeri i tyre, vëllam me Takon. E gjetën tek po çlodhej në kasollen e tij. I thanë se i kishte dërguar Takoja, donin t'i strehonte. I futi brenda dhe u shërbeu dhallë të ftohtë, që të çlodheshin. Dhe aty bënë marrëveshjen. Të dërgonin në qytet djalin e tij të birësuar me një enë me qumësht, gjoja për ta shitur. Hristo i dha masat, e porositi që të kthehej me dy palë rroba allafrenga dhe këpucë. Dhe kryesorja, të mësonte se ku ishte hoteli që rrinte ledi. I dha disa monedha me vete. “Njëra është për ty”, i tha dhe i shkeli syrin. Dhe ai rrinte dhe e vështronte i habitur për njëfarë kohe, derisa ta kuptonte e t'i dhuronte një buzëqeshje deri te veshët, i gëzuar për fatin që i erdhi në derë.

Hristo Arvanitaki dhe Dhrako u çlodhën, u rruan dhe shkurtuan flokët e gjatë, që të mos ngjanin më me njerëz të egër kur të zbrisnin në qytet. Pamja e tyre kishte ndryshuar. Shikonin njërit-tjetrin dhe bënin shaka. “Je bërë që të të vizatojnë një portret në qytet”, i tha Dhrako. Dhe Hristo ia ktheu duke i thënë se për pak do të kujtonin se ishte ndonjë lord në Athinë. Pasdite vonë u nisën, të shoqëruar nga Tambaleksi. Njeri fjalëpakë, nuk ia nxirrje lehtë

fjalët. Ndoshta ishte dhe i frikësuar. Kur mbërritën në Proastio, në Neapoli, vështronin përreth atë fshat paqësor dhe të qetë, me shtëpitë e ulëta dhe ornamentet nëpër çati, me oborret e gjelbëruara me hardhi dhe akacie. Nga lart dukej qyteti që shtrihej në këmbët e tyre. Ecnin shpejt dhe këpucët filluan t'i vrisnin, ngaqë ishin të pamësuar me lëkurën e tyre të fortë, të mësuar një jetë me opingat me të cilat bridhnin maleve. Pastaj kaluan Dheksameninë dhe u ranë vreshtave mes për mes. Barinjte përshëndesnin Tambaleksin dhe rrinin duke i vështruar të habitur teksa ata largoheshin. Për njëfarë kohe u vinin ende në vesh tingujt e këmborëve të deleve dhe të dhive.

Dhrakosit, kur pa Manastirin e Shenjtëve Asomaton, i erdhën ndër mend histori të vjetra, u frymëzua, dhe filloi të tregonte për bëmat e bandës së kryebanditit Qiriako Malishova, që mbrohej nga i mbiquajturi “Xhube”, Vulgari, në qershor të vitit 1863. Në muajin mars, Georgios ishte përzgjedhur për t'u bërë mbret i grekëve, pas mospranimit të tetëmbëdhjetë pinjollëve të tjerë të familjeve mbretërore të Europës, që të merrnin fronin e Greqisë. I ati i tij, mbret i Danimarkës, nuk kishte konsideratë për grekët. I quante “mjeranë” dhe “komb banditësh”. Kësaj ngjarjeje i kishte paraprirë një orgji e vërtetë dhune dhe krimesh. Në shkurt, Vulgari tentoi të merrte pushtetin me grusht shteti. Disa u përpoqën të rrëmbenin të bijën e guvernatorit të Bankës Kombëtare, G. Stavros. Dhe Asambleja Kombëtare votoi për një shtesë të majme të pagave të 317 deputetëve dhe, në të njëjtën kohë, për shkurtim të pagave të nëpunësve të sektorit publik dhe për vendosje taksash për blektorët. Këto ryshfete egërsuan opinionin publik. Njerëzit thërrisnin: “Ooo koprracë, ooo shfrytëzues, ooo...”. Disa politikanë u rrahën keqas. Po, banditët ishin strehuar së bashku me Qiriakon, me atë vetë, me Takon dhe me shtatëdhjetë të tjerë, nëpër qelitë e murgjve. Jashtë, bënin paradë xhandarët që kishin

ardhur për t'i arrestuar. Por edhe ata ishin njerëz të “Xhubes”, dhe në radhët e banditëve, shumica ishin ish-xhandarë dhe ushtarë që kishin dezertuar, pra ishin kolegë. U pajtuan dhe u bashkuan kundër qeverisë. Dhe arrestuan, për t'i mbajtur pengje, ministrat Kumundhuro dhe Kalifronia.

Dhrakoja, i entuziazmuar siç ishte, mori zjarr. Dhe pasi përshkuan vreshtat në rrugën *Sekeri* e u futën në *Rrugën e Maratonës*, ai i drejtoi pothuajse me zor, para pallatit mbretëror, që t'u tregonte për ngjarjet. U tha se në sheshin *Sintagma* u përlëshën Malësorët e qeverisë dhe Fushorët e Vulgarit, të cilët përpiqeshin të pushtonin pallatin. Plumbi i një banditi rrëzoi përtokë të birin e Konstantino Kanarit, Aristidhin. Por nuk u mjaftuan me kaq. Gjatë varrimit, Fushorët qëlluan me armë arkivolin. Kaq shumë urreheshin mes tyre. Po, Dhrako i ka edhe tani para syve sulmuesit dhe ata që po mbroheshin, dëgjon gjëmimet e topave, krismat e armëve, britmat dhe ulërimat e të plagosurve nga dhimbjet. Dëgjon kujën. Përjeton përsëri ekstazën e betejës. Psherëtin. Në atë kohë, ishte akoma në moshën e rinisë së parë, i ziente gjaku.

Hristo shikonte i habitur pallatin, vështronte evzonët e gardës të vendosur që e ruanin. Dhe përballë ndërtesat madhështore të Janopullosit dhe të Palit. Por edhe ndërtesën Dhimitriu, ku strehohej Shkolla Arkeologjike Franceze. Aty ku para disa vitesh, më 1861, studenti Aristidh Dhrosos tentoi të vriste mbretëreshën Amalia. Doli nga burgu dy vjet më vonë, kur gjatë ngjarjeve të qershorit, u hap Medreseja dhe dolën nga burgu keqbërës të të gjitha kategorive. “Ja edhe *Hoteli i Anglisë*”, ia bëri Tambaleksi, duke e treguar me dorën e djathtë. Që aty u nisën lordët së bashku me shoqëruesit e tyre me karroca për në Marathonë. Vështrimi i Hristo Arvanitakit ngriu, u ngul në një pikë. Dhrako e kuptoi. “Eja”, pëshpëriti. “Do të vijmë më vonë.” Dhe hynë në rrugën *Ermu* me

dyqane të stilit europian. Vështronte majtas dhe djathtas. Veshje, këpucë, enë shtëpiake. Pastaj rrobaqepësi, kovaçhana, opingarë. Tani i ndienin këmbët që u ishin bërë plagë në ato këpucë të sarta. Ç'të bënin? Vazhduan rrugën. Hristo u mërzi. U ndeshën me fshatarë të veshur me fustanella që zbrisnin në qytet nga fshatrat përreth, me kalimtarë të veshur allafirënga dhe gra tërheqëse, që ngjanin si valltare indiane me fustane europiane dhe kapelë, si shtojzovalle. Kaluan para kancelarisë së Palit, para librarisë së Karl Vilbergut, dyqanit të dhuratave të Rodolf Maifartit me logon e firmës të vendosur në hyrje, lart te tabela, dhe para dyqanit me argjendari të Pomonit. Dhe në atë çast fytyra iu çel, u qetësua në një mënyrë të pashpjegueshme. E rigjeti humorin e humbur. Dukej sikur ëndërronte, i zhytur në mendimet e tij. Dhe befas, diçka ndriçoi si vetëtimë në mendjen e tij.

Pas Kapnikareas, u kthyen djathtas në rrugën *Eollu*. Aty e lanë të lirë Tambaleksin. Arvanitaki i dha një bakshish të mirë. “Mirupafshim! Do të takohemi përsëri në kthim, te stani”, u tha. Ata vazhduan. Dhrakoja, si në ekstazë, filloi përsëri të tregonte. Më 20 qershor luftimet u bënë më të ashpra në rrugën *Stadhiu*, në bulevardin para Universitetit, këtu pak më poshtë, në kishën e Shën Irinit, më tutje, te “topat”, dhe në *Omonia*. Sheshi *Omonia*, sheshi i urrejtjes. Beteja ishte e ashpër. Vetëm aty u shembën përtokë të vdekur pothuajse njëqind veta. Dhe atë ditë bënte një vapë e padurueshme, zagushi...

Shumica e karrocave tashmë kishin ikur nga sheshi *Shën Irini*. Një a dy prej tyre qëndronin pa lëvizur në një cep. Shkretëtirë. Lanë pas *Ëmbëltoren e Pavlidhit* dhe dalluan hotelin e tyre. “Ja ku është hoteli”, tha Dhrakoja, dhe Hristo u kthye për ta parë. *Hoteli i Kurorës*. Sheshi i Ludovikut. Dhe aty Banka Kombëtare. Dhrako qeshi mbyturazi. U ndalën për një moment. “Ta dije

se çfarë u bë këtu... zallamahi e paparë... Për pak do të kishim siguruar gjithë jetën... Kishim zënë hotelin, shtëpinë e Simos dhe shtëpi të tjera, u pozicionuam aty, të gatshëm për të goditur malësorët”, tha, dhe në gjendje ekstaze tregonte shtëpitë përreth. “Përballë, në Bankën Kombëtare, Georgios Stavru, guvernatori, edhe ai njeri i “Xhubes”, futi brenda një njësi xhandarësh, njerëz nga tanët. Dhe teksa po studionim mënyrën se si të futeshim brenda në gjithë atë rrëmujë, që të vidhnim çka kishte aty, lira, franga, dhrahmi... gjithë ai ar... dhe të zhdukeshim nga faqja e dheut... u faneps ai i mallkuari Koroneos, ministri, me burrat e armatosur të njësisë së tij. Beteja u ndez. Atëherë u futën në mes fuqitë e mëdha, Anglia, Franca dhe Rusia, dhe u dhanë fund vrasjeve. Më shumë se dyqind vetë kishin humbur jetën atëherë. Gjithandej të vvarë, të flakur rrugëve. Ne na strehoi Stavru për dy ditë në shtëpinë e tij dhe në vazhdim na përcollën fshehtazi njerëzit e “Xhubes”. Siç shihet, edhe atëherë kishim njerëz nga tanët, që kishin autoritet në qytet. “Xhubesja” ishte i fuqishëm në atë kohë. Dhe çfarë i bënë, kujton ti? Që atëherë, është bërë pesë herë kryeministër. Por shansin e humbëm. Grabitja e madhe nuk u bë kurrë. Vetëm *Hotelin e Kurorës* si dhe shtëpitë përreth ia dolën të grabisnin trimat e Qiriakos. Dhe ai i jepte vetes rëndësi. Ishte një megaloman... Synonte të bëhej kryebandit, që t’i bënë edhe këngë. Por nuk u bë.”

Arvanitaki e dëgjonte gojëhapur. Në të vërtetë, diçka i kishte thënë Takoja, por gjëra të përgjithshme. Por këto hollësi nuk i dinte. Po, pothuajse dyqind kishte arritur atëherë numri i të vvarëve. Një gazetë kishte shkruar: *E frikshme ishte gjendja pas mbarimit të luftimeve. Kufoma njerëzish dhe kuajsh, në pellgje gjaku, të shpërndara në shumë pika të Athinës, dukë përhapur një erë të rëndë, kryesisht prej vapës së padurueshme. Në Sheshin*

e Ludovikut, para Bankës Kombëtare, ishin formular rrëke të frikshme gjaku që kishin përmbytur sheshin, ndërsa gjithë sipërfaqja përreth, në një rreze të madhe, ishte skuqur ngaqë njerëzit kishin shkelur mbi këtë gjak dhe e kishin përhapur. Në të gjitha shtëpitë shiheshin vrima të mëdha dhe të vogla, prej plumbave dhe predhave... Atdheu sot, veshur me të zeza, vajton për këto humbje.

Por, ndërkohë, ishte errësuar. Fenerët me gaz në shtyllat e rrugëve u ndezën. Kurora verdhacuke e lagështirës rrethonte këta fenerë. Shikonin hijet para tyre të holloheshin, të bëheshin si shirita, të zgjateshin, të lartësoheshin, a thua se ishin shalëgjatë që ecnin anës rrugëve. Vazhduan rrugën për t'u futur në hotel. Në atë çast u përballën me dy “të fortë”, kopukë që kërkonin sherr. Mënga e xhakëtës kaluar vetëm në një dorë, mënga tjetër e lirë, varej, supet të rëna, koka e ulur. U ndalën për një moment, dhe i vështruan në një mënyrë të çuditshme. Ishin rrugaçë, dhe rrugën e konsideronin pronë të tyre. Me vështrime arrogante prisnin që të huajt t'u hapnin rrugë. Kështu duhej të silleshin të gjithë para këtyre trimave. Hristo u nxeh. “Maskarenjtë”, mërmëriti. U mat të vinte dorën në brez. “U çmende?”, i pëshpëriti Dhrako dhe i kapi dorën. I tregoi xhandarin që qëndronte te cepi dhe i ndiqte nga larg. Nuk duhej të hapnin telashe, se do të ngatërroheshin keq dhe do t'i rrasnin në burg. U zmrapsën, u hapën rrugë dhe trimoshët drodhën mustaqet duke buzëqeshur të kënaqur. Frymëmarrja e tyre kutërbonte erë alkool. Ecnin duke iu marrë këmbët, me sytë gati të perënduar.

“Pizevengët!”, pëshpëriti Arvanitaki dhe hynë në hotel të nervozuar. Kërkuan një dhomë dyshe. U regjistruan me emra të tjerë. Arvanitaki si Papadhopullos, ndërsa Dhrako si Agraftoti. Porositën dy pjata gjellë dhe pastaj të lodhur vajtën në dhomë.

Hoqën këpucët dhe futën këmbët e tyre të ënjtura në legenin me ujë. U qetësuan dhe pastaj u shtrinë.

Arvanitaki nuk vuri gjumë në sy. Nga njëra anë e torturonte ledi, nga ana tjetër, dysheku i butë. Ngaqë ishte mësuar të flinte nëpër male dhe nëpër pyje, flaku dyshekun, duke thënë me zë të lartë, “në djall me gjithë këtë palokrevat”, dhe u shtri për të fjetur në dyshe-menë e ashpër. U zgjua herët në mëngjes. Dhe këmbëngulte që të shkonin dhe të nguleshin patjetër, që pa gdhirë, jashtë *Hotelit të Anglisë*. Donte të shikonte ledin. Nuk duronte dot më.

Dhrako hoqi të zitë e ullirit që ta sillte në vete. “Ajo është aristokrate, është mësuar ndryshe, nuk zgjohet me pulat. Hajde, vëlla, pimë një kafe në Agora, të na hapen sytë, dhe pastaj shkojmë aty.” Bëri ashtu siç i tha Dhrako. Ndërkohë donte që pasdite vonë, para se të ktheheshin në hotel, të kalonin nga Psiri. I erdhën ndër mend fjalët e Vajnerit, vargjet e tij. Tha se ishte kureshtar të shihte shtëpinë e Tereza Makrisë. Dhe nëse ishte me fat, ta shihte edhe vetë atë. Çfarë pamjeje do të kishte tani në pleqëri ajo bukuroshe? Qoftë dhe në kuptimin metafizik. Koha, gjurmët që lë te bukuria, konsumimi, caqet e limituara të ekzistencës. Dhe në darkë, të bredhin rrugëve, të kalojnë nga femrat. Aty më poshtë ishte një “shtëpi”, ia tregoi Selami, spiuni i Takos. Që të argëtoheshin. E kishte të nevojshme. Kishte kaluar mjaft kohë...

Ecën përgjatë rrugës *Eollu* drejt Akropolit dhe arritën në Sheshin e Agorasë. Qyteti ishte zgjuar me kohë. Dhe aty u ulën në një kafene. Hoqën për një çast këpucët, dhe fërkuan përsëri këmbët e tyre gjithë plagë. Dhe mbetën duke vështruar kalimtarët. Tregtarët ambulante reklamoni salep, kuleç, hajmali, bimë mjekësore. Dhe zërat e tyre bëheshin njësh me zhurmën që vinte nga dyqanet, pijetoret, gjellëtoret që bëheshin gati për ditën

e re, me goditjet mbi kudhër në kovaçanat që ndodheshin pak më tutje. Sharlatanë, hajdutë, kokoroshë, mashtrues - të gjithë aty kalonin, të përzier me turmën. Halabakëria e Athinës në gjithë lavdinë e saj. Parakalim. Me bëmat, britmat dhe lëvizjet që bënin. E kush do t'i pengonte të shprehnin budallallëkun e tyre? Hamaj maltezë transportonin duke i mbajtur në shpinë mobilie, thasë, bohçe. Po, shikonin dhe dëgjonin gjithë atë mizëri njerëzish që bërtiste, mallkonte, shante, shihnin heqësit e dhëmbëve tek rrinin në cepin e tyre, mjekët popullorë, dermatologët që reklamnin shushunjat për thithjen e gjakut, berberët, shitësit e parfumeve. Dhe papritur u shfaqën fëmijët e rrugëve. I panë tek shëtisnin pa ndonjë qëllim lart e poshtë, me duart futur thellë në xhepa. Kishte ardhur momenti që ata të shfaqeshin në skenë. Dhe papritur filluan të këndonin me zë të lartë: “Xhaxha Jani i kanave”. Në atë çast u kthyen dhe e panë me gomarin e tij të ngarkuar me kana dhe shtamba. Vinte nga rruga *Iperidhu*. Dhe fillonte të bënte xhiron e përditshme. “Xhaxha Jani me shtambat... dhe kanat e vogla... të na rrosh sa malet...”, i këndonin dhe e ndiqnin nga pas duke u argëtuar. Por, pas pak, ajo turmë picirrukësh e braktisi për hatër të një qeni rrugësh, që për fatin e tij të keq iu doli përpara. Shtambari shpëtoi, por qeni gjeti belanë. Ngriti kokën për të nuhatur njerëzit dhe shtëpitë aty rrotull. Por ia prenë menjëherë hovin. I gjuajtën me gurë dhe me dru që gjetën aty. Në fillim lëshoi një kuisje të mbytur, pastaj hungëriti prej dhimbjes dhe në fund filloi të lehtë e egërsuar. Por çfarë mund të bënte? Shpejtoi që të largohej. A mund t'ia dilte asaj turme?

Kështu po sodisnin, të heshtur. Hristo Arvanitaki rrinte si mbi thëngjij të ndezur. Mendimet i ishin bërë lëmsh. Ledi, lordët, Tako. Filluan të binin kambanat për meshën e mëngjesit të së Hënës së Madhe. Iu kujtuan Pashkët në Arhani të Ftiotidhës para

tre vjetësh. Iu kujtuan fëmijët që pagëzoi banda dhe banorët e fshatit me të cilët u bënë kumbarë. Iu kujtuan Pashkët në Maratho dhe në kishën e Taksiarhëve. Gjithçka në mendjen e tij ishte e ngatërruar. Diçka u thye brenda vetes së tij. Në kujtesë iu rikthye ledi. Në atë moment, kur po rrufiste kafënë, filloi bisedën, që të largonte atë ide që i ishte bërë fiksim. “Dhrako, si u gjende këtu? Kaq larg vendit tënd? A nuk është shumë larg?”

Dhrako ngriti kokën dhe e vështroi. Mbeti i heshtur për disa momente, duke u menduar. Vështrimi i tij ishte i humbur, udhëtonte larg, i fiksuar pas diçkaje. Psherëtiu. Hapi gojën dhe filloi të tregonte historinë e tij. Se si vrau një turk në vitin 1854 në ishullin ku jetonte, i cili u kishte vënë syrin pronave të familjes, dhe i duhej të ikte, për të shpëtuar kokën. Tregoi se si gjeti rastin, pasi kishte filluar kryengritja në Thesali. I hipi një anijeje së bashku me patriotë të tjerë të tij, të cilët u nisën ato ditë për të ardhur këtu që të luftonin, dhe arriti në Pire. Para se të ikte për në front, jetoj ca kohë duke bredhur në Athinë, njohu qytetin. Pastaj erdhi humbja, dhe ai mbeti në Greqi. Ku të shkante? Të kthehej në Qipro? Ishte i humbur, e prisnin turqit që ta qëronin. Kështu që mori malet, me trupën e kryebanditit Kallabaliki, mik i vjetër i Davelit. Aty u njoh dhe me Takon. Dhe që atëherë nuk ishin ndarë, bile edhe atëherë kur banda u shpërnda prej përndjekjes së xhandarëve.

“Të ka marrë malli për atdheun tënd, ore Dhrako?”

Dhrako përsëri mbeti për pak sekonda i heshtur. Iu pre çehrja. Zëri iu këput. “Ti, si thua? Fshati im ndodhet në pjesën veriore të ishullit, në një fushë të gjelbëruar, anës detit, afër Kerinias, nëse e ke dëgjuar. Është një parajsë e vërtetë.”

“Ke lënë familje?”

“Prindërit e mi të moshuar. Nuk e di nëse jetojnë apo jo...”, iu përgjigj. Dhe u mbyll në vetvete, iu lidh gjuha. U kthye anash

dhe vështroi drejt Akropolit, lart në qiellin e kaltër, aty ku një re e bardhë po udhëtonte vetëm, e harruar. Po, dëshironte që një ditë të kthehej në vendin e tij. Me gjithë shpirt e zemër, jo me gjysmë zemre.

“Imagjino, që kaq kohë nuk më kishe thënë asgjë nga të gjitha këto”, e ndërpreu nga ëndërrimet Arvanitaki.

Dhrako tundi kokën. “E ç’rëndësi ka... Aty lart është një gjykatës i padukshëm, që e shpërndan dhimbjen te të gjithë ne”, psherëtiu ai. Tani e kishte ai radhën që të harrohej në mendimet e veta.

“Pak më lart është Medreseja. A nuk hidhemi një vrap?”, e nxiti Dhrako. “Prej aty doli atëherë Qiriako, ishte urdhër i ‘Xhubes’. Këtu më lart!”

Hristo nuk donte. Dhe ia preu hovin si me thikë. Kishte ndër mend gjëra të tjera. Atë të huajën, ledin. Kështu që morën rrugën për në *Sintagma*.

“Që thua ti, aty në Medrese e mbyllën një herë e një kohë Bibisin. Dhe te rrapit që mbolli, varnin banditët gjatë viteve që pasuan”, vazhdonte rrëfimin e tij Dhrako.

“Bëji të fala rrapit, që thonë”, bëri shaka Arvanitaki. Dhe pastaj u dëgjua e qeshura e tij buçitëse. Po, këtu vdekja mori shumë banditë me vete.

Në rrugën e Parlamentit u bllokuan në turmë dhe në rrëmujën që mbretëronte aty. Trotuari ishte i zënë. Shitës zarzavatesh, teneqexhinj... *Kasapi, çengelat e të cilit përbënin rrezik për sytë e kalimtarëve, kur në to nuk vareshin dele të porsatherura me kokën poshtë, të mbuluara me lëkurët e tyre të kthyer së prapthi dhe që preknin tokën. Dele të tjera rripeshin brenda thertoresh ose prisnin që t’u vinte radha, duke blegërirë vajtueshëm. Përtokë dergjeshin zorrë dhe plëndësa, dhe rrotull tyre korba të zbutur*

dhe tre qen të neveritshëm rrugaçë të llojit bulldog, që kishin ngjyer turinjtë e tyre në atë llum prej gjaku - me këto ngjyra të gjalla e përshkuante gjendjen një letrar i kohës.

Në rrugën *Ermu*, Arvanitaki ndali hapin, për një moment hezitoi dhe pastaj u fut në dyqanin e fotografit Ksonofon Vathi, duke e lënë me gojë hapur Dhrakon, që i shkonte i bindur nga mbrapa. “Çfarë mund të bëj për ju zotërinj?”, brofi nga karrigia ku ishte ulur fotografi, duke fërkuar duart. “Të më bësh një resme, dua!”, ia bëri Hristo. Dhrako rrinte dhe vështronte i habitur. Fotografi e ftoi Arvanitakin të kalonte në pjesën e brendshme të dyqanit. E vuri të qëndronte drejt, para atij sfondi të rremë idilik dhe i bëri disa poza. Dhe Hristo qëndronte, dhe priste që të merrte fotografinë. E donte në atë çast. Vathi qeshi dhe i tha që të kalonte një herë të nesërmen. “Nuk bëhen kështu këto punë, fotografia, ashtu si buka në furrë, kërkon kohën e vet që të bëhet”, i tha. “Nuk janë gështenja që t’i mbështjell, t’i marrësh dhe të ikësh. Fotografi do të jetë gati nesër, rreth mesditës.” Dhe Arvanitaki që nuk e dinte se çfarë ishin in... instan... nejse, i premtoi që do të kalonte të nesërmen. Patjetër.

20/E2

Dosja: “Vetëvrasje”, fashikull nr. 22

Komuniteti i Leonidhios mbeti i shokuar nga ngjarja tragjike që ndodhi në shesh...

Leonidhio, 1 mars 2013

Shtëpia në shesh është e mbyllur. Të mbyllura dyert, të mbyllura dritaret. Vetëm grilat janë paksa të ngritura, për të depërtuar pak dritë. Dhe ai qëndron pranë krevatit të saj, në gjysmë errësirë. Tri ditë. I mban dorën, atë dorë kockë e lëkurë mbushur me njolla të murrme, dhe i flet. Ajo shtrihet. E dëgjon dhe nuk flet. I duket sikur po lëviz kokën e saj në mënyrë të pavetëdijshme, po, e lëviz kokën në mënyrë të pavetëdijshme. Sheh hijen e saj, formën e trupit të saj nën çarçaf.

I vjen ndër mend ajo kohë, kur ishte djalë i vogël, dhe nisej për në shkollë. Trasta e librave, pantallonat e shkurtra, sandalet. Fluturonte nga krahët e saj si një zog dhe në drekë kthehej për t’u futur përsëri në prehrin e saj. Duart e saj ishin si dy krahë të mëdhenj fluturues.

“Nënë, a të kujtohet? Atëherë që theva dorën? Sa shumë që më dhembte, sa kam qarë. Dhe ti, ulur në stolin e spitalit, më ledhatoje, puthje kyçin e dorës sime që më dhembte dhe thoshe: ‘Qetësohu, qetësohu, tani do të vijë mjeku, dëgjoj hapat e tij. Qetësohu...’. Edhe... atëherë kur më mbaje përdore, pëllëmba jote ishte aq

e ngrohtë, dhe më çoje tek ëmbëltoja që të blija çokollatë me qumësht, ION. Më pëlqente kaq shumë ajo çokollatë, sa që kaloja gjuhën mbi buzë dhe e shijoja, pa u futur akoma në dyqan. Më kapte nepsi... Vërtet, a e mban mend? Buzëqeshje dhe buzëqeshja jote përhapej në të gjithë botën.”

Rri ulur gjatë gjithë kohës, gjithë ato ditë në krah të saj, pa venë gjë në gojë. Qëndron për t’i bërë shoqëri, të mos ndihet e vetmuar. Dhe ia kujton të gjitha ngjarjet. Gëzimet dhe hidhërimet. Dhe herë pas here buzëqesh, fytyra e tij ndriçon papritur dhe pastaj bie përsëri në humnerë, ngryset, lotët rrokullisen nga sytë e tij, i lë që të rrjedhin, të bien në dorën e ngrirë dhe të bërë si dru të nënës së vet.

Kështu do t’i kalojë ato tri ditë në krah të saj. Ndërsa ditën e katërt, do të bëjë një lak me litar dhe do ta fiksojë te tavani.

Fqinjët kishin ditë që nuk i kishin parë. Era e rëndë që përhapej jashtë shtëpisë, i vuri në dyshime. Lajmëruan policinë. U desh të shpërthenin derën. Nënëni plakë e gjetën në stad të avancuar dekompozimi, të mbuluar me çarçafin-qefin. Ndërsa të birin e gjetën të varur në tavan, me kokën të kthyer anash. Fqinjët thanë se që të dy nuk kishin burime financiare për të përballuar jetesën. Shumë herë i ndihmonin me sa mundeshin. I biri ishte i sëmurë, *e kuptoni, kishte probleme psikologjike...* Kur e ëma vdiq, nuk mundi ta përballonte.